

LUAN
QAFEZEZI

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-3L
216.



**Në brigjet
e Semanit**

NOVELË

814.52
216.

Luan Qafëzezi

NË BRIGJET E SEMANIT

Novelë



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Maj i vitit 1952.

Nëntoger Telo Bani, nuk i shijoi ato ditë pranvere. Pas aq vjetëve me rrobën ushtarake në trup i kishte ardhur urdhri i daljes në lirim. Nuk e kishte pritur dhe aq mirë atë urdhër, me gjithë mallin që kishte për vendin e tij të vogëlisë. Koha e luftës e pastaj ndeshjet me armiqtë buzë kufijve të atdheut e kishin lidhur ngushtë me ushtrinë.

Po urdhri ishte urdhër. Partia, në këtë periudhë kur shtronte çështjen e kolektivizimit të fushave, kishte nevojë për kuadro të luftës e të revolucionit që t'i qëndronin në krye kësaj beteje të vështirë. Dhe ja, më në fund, ai arriti në Ilirasin e tij të vogël, ku çdo pëllëmbë tokë ruante një kujtim të afërt ose të largët për të. Po vargu i kujtimeve s'kishte të mbaruar! Eh, sa herë ishte endur e kishte bredhur këmbëzbathur e barkunfir fushave e livadheve duke ruajtur bagëtitë e të zot, e sa herë kishte luajtur e ishte prehur shkurreve e korijsheve me moshatarët e vet! E, me gjithë urinë e varfërinë e asaj kohe, ato lëndina, shkurre e korijshe fshihnin në vetvete diçka të ëmbël e të shtrënjtë për të. Duke i kundruar iu përtërinë tërë ato ditë me dliresinë e pafajësinë e tyre të vogëlisë.

E ja edhe gjoli që mbahej në gojë për thellësinë e kthjelltësinë e tij. Pak më tej shtrati i një lumi të

vdekur, si e quanin vendasit, e pastaj, Semani, që si gjithnjë, i qetë e i heshtur, gjarpëronte përmes fushave të gjëra të Myzeqesë. Atje dikur lahej verës. I kundroi të gjitha me radhë e pastaj, në fund të atij vargu kujtimesh, midis shokëve të tij, Hysni Gremi erdhi e i mbeti ndër sy i gjallë...

*

* *

Qenë të zjarrta ato ditët e korrikut të 43-së, kur Telo Bani dhe Hysni Gremi dolën partizanë. I pari sapo kishte shkelur në të gjashtëmbëdhjetat, kurse i dyti ende s'i kishte mbushur të tetëmbëdhjetë vjetët.

Ashtu siç e kishin vendosur, ashtu edhe bënë: të pandarë në fshat e në bangat e shkollës fillore e prapë bashkë po niseshin atje ku këndoheshin këngët që të ndiznin zemrën zjarr.

— Hysni, ki mendjen, të keqen nëna! — i pëshpëriti e ëma duke e shtrënguar në krahë.

— U kthefsh me nder, bir! — i tha edhe i ati duke e puthur në ballë.

Pastaj:

— Hysni, Hysni, — u dëgjua zëri i të vëllait duke iu derdhur në krahë.

Ai e përqafoi.

— Ceno, — i tha, — ki kujdes, t'i bëhesh krah shtëpisë dhe babait! Tani veç teje... Pastaj, duke e rrëmbyer ndër krahë e puthi fort Vitën e vogël, që ende s'i kishte mbushur të nëntë vjetët.

Në këtë çast një zë u ndie në afërsi të oborrit:

— Niko, mos i bëj për të qarë xha Sharen dhe nënë Dilën!

— Eh, djall, o Telo! Ti kurrë s'ke për të hequr dorë nga shakatë! — tha plaku duke i dhënë zemër vetes e duke e shikuar me dashuri djaloshin që posa kishte dhënë ballë.

— Erdha, xha Share, erdha për tu dhënë zemër! Sa për Nikon, mos ia kini merakun! Në male do ta kem vetë kujdes, — dhe buzagas pas kësaj shakaje i mori dorën nënë Dilës e ajo si Hysniun e përqafoi dhe e puthi në të dyja faqet. Ashtu bëri pas së shoqes edhe Share Gremi.

— Mirë! — tha djali së fundi, — ju më puthët si më të mëdhenj, tani më erdhi radha mua! — dhe duke qeshur përqafoi e puthi Cenon e pastaj edhe Vitën, duke e ngritur lart e duke e shtrënguar fort midis krahëve të tij.

Kjo qe e gjitha. Pastaj të dy shokët u nisën dhe, nëna, babai, Cenoja e Vita i ndoqën me sy gjersa u zhdukën te kthesa e fundit, në të dalë të atij fshati të vogël.



Kishin kaluar disa muaj që nga korriku i 43-së. Italia fashiste kishte kapitulluar, kurse pushtuesit e rinj, nazistët gjermanë, duke hedhur në luftim divizione të tëra, kishin shpërthyer në mbarë vendin një ofensivë të egër e të paparë. Në një nga ato ditë batalioni ku bënë pjesë të dy shokët, i gjetur midis zjarresh, ishte vënë në gjendje të vështirë.

— Telo — i tha Hysniu. — Unë po shpejtoj për ta zënë atë çukë. Ndryshe, po ta arrijnë ata më parë, dara e rrethimit do të na mbyllet plotësisht! — dhe, pa pritur përgjigjen e shokut, Hysni Gremi shpejtoi

dhe duke e kapur majën hapi zjarr mbi atë mori ushtarësh të armikut që vërshonin duke thirrur. Në çast thirrjet pushuan e pastaj, edhe ai vërshimi i tyre u ndal:

— Të lumtë, Niko Gremi, të lumtë! — thirri komisari duke e vërejtur që tej partizanin që u ishte bërë krah shokëve në këtë çast të vështirë. Pastaj, pa humbur minutën, Stavri Kondakçiu dha urdhër që batalioni të çante përmes grykës së hapur nga Niko Gremi e të vendosej në pozicione të reja luftimi.

Pas këtij veprimi gjendja ndryshoi mjaft, me gjithë shpërpjesëtimin e madh të forcave midis të dy palëve kundërshtare.

Dhe ashtu lufta vazhdoi orë të tëra. Herë në distanca të afërta e herë-herë edhe me kacafytje e ndeshje trup me trup.

— Dreqi e mori! S'kanë të sosur ujqit! — i tha Telos një nga shokët që po shtinte përkrah tij.

— Po. S'kanë të sosur! — ia bëri ai me gjysmë zëri, pa e larguar nga sytë Hysni Gremin, që tani në shesh të luftimit po përfytej me një prusian dy pëllëmbë më të gjatë se vetja. U shtang për një çast kur i pa të rrokulliseshin për tokë duke goditur mbi njeri-tjetrin e, pastaj, prusianin tek nxori «parabelin». U ngjeth! Arma shkrepëtiu dy herë, pastaj i huaji e hodhi révolverin që iu bllokua e duke kërcyer mbi të plagosurin u mundua t'ia shembte kokën për tokë. Hysni Gremi u përpoq të qëndronte. Dhe s'e dinte që përmes asaj fushe të përgjakur, duke shkelur mbi vdekjen, Telo Bani i shkante në ndihmë shokëve të plagosur.

— Niko! Më ke pranë! — i tha dhe, pa e zgjatur, e qëlloi me kondakun e pushkës prusianin e gjatë. Ai klithi dhe, duke e lëshuar partizanin e plagosur, u

mundua të ngrihej në këmbë. Por, i marramendur, tek bëri të çohet, ra. Nga koka një llavë gjaku i mori fytyrën.

— Na edhe një! — tha partizani dhe shtiu me pushkë mbi të.

— Telo, — i tha Hysniu, duke e parë kundërshtarin të shtrirë, — s'do ta harroj kurrë këtë që bëre për mua, — dhe u mundua t'i buzëqeshte.

Tjetri, i zbetë, i pa plagët që kishte marrë.

— Çohu! — i tha me dhembje. — Çohu të largohemi që këtej... Siç e sheh, jemi shumë thellë...

Hysniu provoi të ngrihej, po nuk mundi.

— S'mundkam! — tha. — Nuk mundkam, Telo. Së paku largohu ti, të lutem!

— Pse flet kot? — e qortoi shoku dhe duke u ulur e hodhi mbi shpinë dhe filloi të zvarritej ngadalë.

— Telo! — tha Hysniu kur arritën matanë — si thua? Po të mos kishte ngjarë kjo që ngjau, ndofta kurrë s'do të ishim ndarë... Sidoqoftë ti e di përse rashë unë. Thuaj nënës të mos më qajë! Ajo ka Cenon e Vitën në këmbë time. Ajo të ka ty e të gjithë shokët e mi, që janë aq shumë...

— Pse flet kështu? — tha me zë të dridhur Teloja dhe ndjeu një si lak ta shtrëngonte në fyt.

— Nejse... edhe një porosi: Tregoju babait dhe Cenos se si rashë. Por jo Vitës së vogël. Atë vetëm përqafoje edhe një herë nga unë.

— Hysni! — e qortoi rishmëz tjetri i pikëlluar.

Ai e dëgjoi si nëpër gjumë, pastaj koka iu var e sytë iu mbyllën përgjithmonë.

Kështu ngjau. Në mbarim të luftimit trupi i tij u varros me nderime dhe shokët me komisarin e komandantin në krye shtinë për kujtimin e të rënit. Edhe Telo Bani shtiu si të tjerët.

Në mbrëmje ai u hoq mënjanë dhe i shkroi një letër të atit të Niko Gremit.

Të nesërmen forcat partizane vazhduan të msynin mbi pushtuesit dhe Telo Bani asnjëherë s'e harroi shokun e tij të fëmijnisë.

Shpesh i dukej sikur e shihte të gjallë, duke luftuar kundër asaj morie të madhe gjermanësh, sikur akoma me automatikun në duar shtinte e thërriste:

«Kaput Hitler! Përpara, përpara, shokë!»

Dhe ashtu, sa më shumë bënin përpara gjatë luftimeve, aq më shumë i dukej sikur i përgjigjej asaj thirrjes së njohur: «Kaput Hitler! Përpara, përpara, shokë!» që s'kishte për ta harruar kurrëndonjëherë.

Dhe vërtet, ai ashtu bëri, gjer në ditën e fundit të çlirimit të atdheut.

* * *

Atë mbrëmje maji të vitit 1952 shtëpia e Telo Banit u mbush plot e përplot me njerëz. E gëzuar, nënë Esmaja priti e përcolli miq e farefis. Të fundit mbetën familja e Share Gremit. Telos, sado që ishte i lodhur nga udha, ia kishte ënda të fjalosej e të çmallej me ata njerëz aq të mirë, që e kishin dashur aq shumë e që shpesh në letra e biseda e quanin si Hysniun.

Dhe me të drejtë. Një botë e tërë kujtimesh e lidhte me këtë familje. Veçse, si për çudi, duke i parë një nga një, i dukej sikur s'ishin më ata që kishte lënë, sikur diçka e papritur e kishte ndryshuar secilin prej tyre. Nënë Dilja dhe xha Sharja kishin filluar disi të zbardheshin. Cenoja që bërë burrë, kurse Vita, dikur e vogël, që rritur e zbukuruar aq shumë,

sa që atij atë natë i kishin mbetur sytë tek ajo! Ai e kishte takuar edhe dy vjet më parë, kur kishte ardhur për pushime, pa ndryshe i qe dukur atëherë.

Tani me atë shtat të hedhur e të drejtë, me atë fytyrë të bardhë e më ngjyrë trëndafilie, me ata sy gjithnjë të qeshur e xixëllues, që të kujtonin qiellin plot yje në netët e ndritshme të verës, kishte diçka krejt të veçantë.

E vështronte dhe përherë e më e shumë ia kishte ënda ta sodiste.

Kështu, të ulur pranë e pranë, ata biseduan gjer vonë atë natë. Po Telo Bani s'i ndjeu ato orë. Diçka e panjohur ia kishte pushtuar zemrën këtë radhë.

Edhe kur ikën mysafirët, fytyra e ëmbël e Vita Gremit përsëri i mbeti ndër sy.

— «Çudi! — tha me vete, — ç'po ndodh me mua sonte kështu? Përse s'më hiqet nga sytë ajo?»

Po as ai vetë s'dinte si të përgjigjej. Veçse një gjë ishte e vërtetë, se gjumi s'po e merrte e mendja, sado që mundohej ta largonte, prapë i shkonte e i mbetej tek ajo.

— «Ja, u bëra 25 vjeç, — tha më së fundi, — e kjo s'di të më ketë ndodhur ndonjëherë!» Dhe ashtu e kaloi atë natë. Sytë vezullues të vajzës s'iu ndanë gjer në agim.

Vetëm kur drita ishte duke mbuluar dhenë e zuri gjumi.

*
* *
*

Ishte në të afruar mesdita kur Telo Bani shkeli në oborrin e shtëpisë së Share Gremit. Plaku i gëzuar doli dhe e prit, e ashtu, si të ishte i biri, e përqafoi

dhe e puthi me mall. Pastaj, duke i vënë të dyja duart mbi supe, e shikoi drejt e i tha:

— Të më vish përditë, Telo, si atëherë kur loznit me Hysniun. Ti e di, unë me ty nxjerr mallin e tij.

Edhe nënë Dilja duke e puthur i tha po ato fjalë. Veçse ndërsa i shoqi u përmbajt, asaj iu përplotën sytë. Pastaj edhe Vita:

— Po, po, Telo, — i tha — duhet të na vish përherë...

*

* * *

Kështu kaloi ajo ditë e udha e Telo Banit në atë shtëpi mbeti e hapur, ashtu siç kishte qenë edhe dikur në vitet e fëmijnisë e të rinisë së tij.

Po edhe në shtëpi të Gremëve, mbrëmjes, kur binte ndonjëherë fjala, ata flisnin me dashuri për oficerin e liruar. Në mënyrë të veçantë plaku. Atij i pëlqente qëndrimi dhe urtia e këtij djali të ri.

— Njëzet e pesë ka, — thoshte shpeshherë, — po gjykon sikur t'i ketë kaluar të pesëdhjetat.

Dhe me këto mendime në kokë, Share Gremi sa herë që të kishte ndonjë hall, do ta thërriste e do ta shkoqiste me të.

— Si thua, Telo?

Djali mendohej e pastaj u përgjigjej ngadalë e me kujdes pyetjeve të bëra. Ndonjëherë, kur s'ishte i sigurt për ndonjë çështje, i thoshte:

— Do të pyes e do t'ju përgjigjem më vonë, xha Share.

— Mirë, bir! — ia kthente plaku i kënaqur nga ky qëndrim i urtë i tij.

— Ja, ai është komunist, — i tha një ditë Cenos, — kurse ju të tjerët jeni mësuar t'u bini punëve shkurt.

Dhe vërtet, Telo Bani matej kur e thoshte fjalën.

Nga këto fjalë të mira që dëgjonte për të, Vita çelej në fytyrë e sa s'fluturonte nga gëzimi.

Por shkakun e këtij gazi as ajo vetë s'dinte se si ta shpjegonte, megjithëse jo rrallëherë s'ishte e zonja ta fshihte në sytë e të tjerëve atë që i ndiente zemra.

«Çudi, — mendonte në heshtje, — çfarë është kjo që mendja s'më hiqet prej tij? Po pse më pëlqen ta kem gjithmonë pranë?! Pse vallë ndihem aq e gëzuar kur flas me të, kur mendoj për të?»

Ky qe fillimi, po udha që po hapej në zemrën e saj nuk e pati fundin aty. Tani edhe orëve të vona të netëve, ajo nuk e ndiente veten të qetë. Një ndjenjë e paprovuar ia mundonte atë zemër të pastër e të parrahur nga valë të tilla. Takimet u bënë më të shpeshta. Vajza shpesh e pyeste e ai i tregonte kujtime nga jeta e nga lufta, e shumë herë edhe përshtypje nga librat që kishte lexuar.

— Vitë, — i tha një ditë, — si shpjegohet që nuk aktivizohesh dhe aq shumë në punët e organizatës së rinisë?

Vajza psherëtiu dhe e zënë ngushtë tha:

— As unë s'di si të të them... Po... babai, lidhur me punën e vajzave.. sikur druhet pak. Bile nga ky shkak më hoqi dhe nga shkolla. Dhe një vit e do ta kisha marrë të mesmen. Tri vjet i mbarova duke ndenjtur tek im ungj, ushtarak në qytetin këtu pranë. Po kur atë e transferuan dhe familja e tij u shpërngul, im atë s'më lejoi të shkoja në konvikt. Kështu... mbeta pa marrë maturën.

— Mirë, Vitë, — tha i menduar Telo Bani. — Unë do të bisedoj me Cenon, edhe me xha Sharen.

Mbas bisedës së Telos me xha Sharen Vita Gremi filloi të aktivizohej në punët e organizatës së rinisë në fshat.

Teloja, si sekretar i organizatës së Partisë, vinte shpesh në mbledhjet e tyre për t'i ndihmuar. Vita gëzohej.

Sa i pëlqente sjellja e tij dhe sidomos mënyra e të shpjeguarit të çështjeve!

— Ai është vërtet njeri, moj nënë! — i thoshte shpesh së ëmës për të.

— Ashtu, moj bijë, ashtu! — ia kthente edhe plaka, që s'e ndante nga Cenoja. atë djalë aq të sjellshëm e aq të mirë.

Vita gëzohej nga ato fjalë.

Por tani edhe takimet e tyre ishin shpeshuar. Herë vinte Teloja tek ajo e herë-herë takoheshin në shtëpinë e Lumes, vajzës së vëllait të Telos. Kështu vazhduan një periudhë kohe, gjersa një ditë:

— Të dua, Vitë! — i tha ai — Të dua shumë. Disa herë jam matur të t'i them këto dy fjalë, po goja më është kyçur. Sidoqoftë mos m'i merr për ters sa të thashë. Unë të dua për gjithë jetën e me gjithë zemër . . .

— Edhe unë ashtu të dua — tha ajo e hutuar, pa e kuptuar si i dolën ato fjalë.

Kështu ndodhi. Pastaj, që prej asaj dite, Telo Bani e Vita Gremi shiheshin edhe më shpesh me njëri-tjetrin. Me sa mall e padurim i priste ai ato çaste!

Fytyra e dashur e vajzës s'i hiqej nga sytë. I dukej sikur akoma i pëshpëriste ngadalë:

— Edhe unë të dua, Telo!

Dhe vërtet ajo e donte aq shumë, saqë çuditej me veten e saj e me atë forcë që i kishte pushtuar zemrën. Asnjëherë s'e kishte provuar në jetë një gjë të tillë, e ja tani, si për çudi, kjo ndjenjë e pushtetshme herë-herë e hutonte dhe e zbrapste nga punët dhe herë-herë tërë gaz e bënte të vërtitej si flutur nëpër shtëpi. Kur ishte në orë të mira, nëna e shikonte dhe gëzohej. Po kur e bija rrëmbehej o nervozohej në ndonjë rast, ajo shqetësohej dhe e këshillonte me urti:

— Ki kujdes, moj bijë, ki kujdes! Çupës si ka hije t'i dëgjohet zëri jashtë derës së shtëpisë!

Ndërsa vetë mendonte:

«Diç po ndodh me të!» dhe ashtu sillte ndër mend sjelljet e së bijës gjatë këtyre kohëve të fundit.

Po edhe Share Gremit në një farë shkalle i kishte rënë në sy ky ndryshim i vajzës.

Një mbrëmje, kur e shoqja ndodhej në magje duke gatuar, ai i tha:

— A e ke vënë re, moj grua? Çupa diçka ka!...

Megjithatë as njërit as tjetrit s'u kishte shkuar ndonjëherë ndër mend halli i vërtetë i saj.

Kështu kaluan muaj. Takimet e dy të rinjve vazhdonin. Ata takoheshin pothuajse çdo mbrëmje te Mezhda e Vahut, ku ajo, ndaj perëndimit, shkonte për të mbushur ujë të pishëm në lumë, ashtu siç mbushnin gjithë vajzat e gratë e tjera të atij fshati.

Po një ditë nuk u shpëtuan dot fjalëve të botës.

— Telo! — i tha ajo e tronditur. — Kam dëgjuar se flitet keq për ne të dy...

Ai u pre në fytyrë. Pastaj, pa e fshehur shqetësimin që e kishte pushtuar, kishte pyetur:

— Nga kush e dëgjove?

— Nga Lumja, — theksoi ajo. — Nga Lumja . .

Ai s'i ktheu përgjigje, veçse u vrenjt e Share Gremi i pezmatuar iu shfaq hijerëndë para syve.

— E zeza! — tha ajo rishtazi, — s'kam hall për vete, po për ty! Babai të do e të beson shumë . . . S'di ç'mund të ndodhë po t'i shkojë në vesh një fjalë e tillë!

Telo Bani përsëri nuk foli. Mendohej:

«A do të mundej, vallë, ta kuptonte Share Gremi dhe njerëzit e moshës së tij? Jo! Sigurisht jo! Ai dhe ata që të gjithë do ta dënonin, duke e quajtur njeri të pandershëm, që kishin shpërdoruar besimin e atyre njerëzve që, duke e quajtur si djalë të tyre, i kishin hapur dyert e shtëpisë».

— Vitë! — tha, pas një heshtjeje të gjatë e të rëndë. — Ti e di, midis nesh s'ka pasur asgjë të keqe... Ti e di, askujt s'i kemi faj. Ne e duam njëri-tjetrin. E megjithatë çështja jonë është delikate. Zakonet tona ende janë të egra. Ato akoma e ndëshkojnë dashurinë. . . — dhe heshti për një çast, si për t'i matur e për t'i peshuar ato që po thoshte.

Vajza e zbetë dëgjonte pa bërë zë.

— Po! Kështu është! Megjithatë ne do të luftojmë për të drejtën tonë e do t'i qëndrojmë cilitdo. Apo jo?

Asaj i pëlqeu qëndrimi i tij i prerë.

— Po, — tha, — veçse përpara se fjala të marrë dhenë, duhet t'ia tregojmë Cenos lidhjen tonë e të kërkojmë ndihmën e tij. Unë e njoh tim vëlla. Ai s'ka për t'u kursyer në asnjë mënyrë . . .

Të nesërmen, Telo Bani, i foli hapur Ceno Gremi.

— Ceno, — i tha. — Kam nevojë për ndihmën tënde. Unë e dua, Vitën. Edhe ajo më do mua. Ne duam të fejojemi dhe kemi nevojë për ndihmën tënde. Midis meje e Vitës, ti e kupton, s'ka asgjë të keqe. Po njerëzit mund të kenë krijuar ndonjë farë dyshimi për afërsinë tonë, kurse gojët e këqija mund ta tjerriin legjendën sipas qejfit. Sa e rëndë do të ishte sikur xha Sharja të dëgjonte ndonjë fjalë nga të tjerët! Ja përse duhet të na ndihmosh. Ta kërkoj këtë si shok dhe si komunist. Në gjen gjë të padrejtë në këto që të thashë, të ma thuash hapët...

Deshi të vazhdonte akoma, po Cenoja ia mori fjalën nga goja. Ngriti kokën dhe pa Cenon. Sytë e tij shprehnin ngrohtësi e mirëdashje.

— Telo, — i tha ai, — më vjen mirë që m'u hape kështu. Unë i kuptova të gjitha e do të bëj çmos për t'ju ndihmuar të dyve. Po ti e njeh tim atë. Ai ka huqet e veta. Po ta kërkonte Vitën ndonjë tjetër, zgjidhja e kësaj pune do të ishte krejt e thjeshtë. Po sidoqoftë, sidoqoftë... unë...

Këtu djali e preu fjalën dhe Telo Bani i tha duke e falenderuar:

— Tani, Ceno, gjithçka mbetet në duart e tua!

Në mbrëmje, ai dhe Vita u takuan në shtëpinë e Lume Banit. Ia tha të gjitha. Ajo e ndjeu veten disi më të qetë.

*

* * *

Nëntori i atij viti hyri me një qiell të vrenjtur e me shira të dendura. Edhe era frynte me tërbim, duke zhvatur me përdhunë gjethet e zverdhura e të ha-

rruara të degëve të pemëve. Fshatarët qaheshin se ende s'ishin mirë me të mbjellat e vjeshtës. Si të tjetrët, edhe Share Gremi, shpesh kthehej i mërzitur, ngaqë punët s'i kishte në terezi, e nga ana tjetër, edhe i biri po i shkonte ushtar në një kohë kur i duhej aq shumë. Po në ato ditë të tjera halle kishte ai e të tjera shqetësime i biri. Disa herë djali që matur të shtrohej këmbëkryq e t'ia thoshte të gjitha. Po fytyra e ngrysur e t'et e kishte frenuar. Ai ia njihte mirë huqet e zakonet.

«Po në e marrtë për ters?! E po tha ai një herë jo s'thotë më po?!» thoshte me vete.

Dhe ja, ashtu, dha e mori ato katër ditët e fundit që i kishin mbetur para nisjes gjërsa më në fund vendosi të bisedonte me të ëmën.

— Nënë, — i tha mbrëmjen e fundit, — desha të të pyes për diçka.

— Fol, të keqen nëna, — tha gruaja.

— Ja, dua të di, ç'mendon ti për Telon? A të pëlqejnë mendja dhe sjellja e tij?

— Po pse ma bën këtë pyetje? Telon një herë e ka bërë e ëma. Ai ka shok veten, more bir.

— Mirë, — tha djali, — po sikur ai të kërkonte ndonjë nga çupat e fshatit tonë, si mendon, a do t'ia jepnin?

— Telos?

— Po, atij! — pohoi djali.

— Uaaaa! Si s'do t'ia jepnin, more Ceno! Do t'ia shpinin më krahë!

— Edhe unë ashtu mendoj, — shtoi djali i gëzuar nga përgjigjja e së ëmës. Pastaj heshti e ajo po vriste mendjen përse i biri ia bëri gjithë ato pyetje! Po s'iu durua e prapë i foli:

— Mirë, more, bir, po ç'deshe të mësoje nga unë?

— Do të ta them, — tha djali, — Ja, sikur për shembull, Teloja të kërkonte Vitën, ti, nënë, ç'mendon, a do të kishte ndonjë kundërshtim babai?

— Vitën?

— Po! — ia ktheu rishtazi ai. — Ta zëmë, për shembull, sikur ta kërkonte...

— Qoftë larg! — tha gruaja. — Ajo e ka Telon siç të ka ty, siç kishte Hysniun. Qysh mund ta harrojë yt atë këtë punë?

— S'është ashtu! — kundërshtoi djali. — Ne Telo Banin s'e kemi as farë as fis, veçse fqinjë e mik si gjithë të tjerët.

— Po yt vëlla atë e kishte bërë vëllamë!

— Lodra fëmijësh! — tha djali — Lodra fëmijësh, nënë!

— Jo, jo! S'është ashtu, more Ceno, s'është ashtu, more bir!... — dhe, si për ta larguar nga vetja atë punë të keqe, plaka pështyu rreth vetes.

— Domethënë as ti s'kishe për ta përkrahur? — tha Cenoja duke e vështruar ngultas të ëmën.

— Për çupën s'pyetem unë, të keqen nëna, po yt atë. Po vendosi ai, çdo gjë është e sosur. Veçse unë s'kuptoj, ç'të shkrepri të ngatërrosh Telon me këtë punë?


Dhe si heshti një çast, prapë shtoi e mallëngjyer:

— Atë e ka nëna si Hysniun... Atë...

Po s'arriti ta mbaronte atë fjalë. Zëri i të shoqit ia preu mendimin në mes:

— Grua! Grua, moj! E po hajde de, se më ra bretku duke pritur.

— E zeza! — tha ajo. — Më doli nga mendja. Ai pret ujin për t'u rruar e unë sorollatem këtu! — dhe e shqetësuar u ngrit e iku, duke e lënë të vetëm e të



menduar të birin, i cili të nesërmen u nis, pa e biseduar fare me të atin.

*

* *

16 Janar 1953. Po bëheshin afro dy muaj që Ceno Gremi ishte larguar nga fshati e nga shtëpia. Mungesën e tij nënë Dilja e kishte ndier thellë.

«Vetëm atë djalë kam», thoshte, e sa për vajzën, sipas mendimit të saj, «ajo ishte derë e botës».

Dhe vërtet, atë vit të shumtë kishin qenë lajmësit që e kishin kërkuar. Po Share Gremi, pa i prishur qejfin njeriu, i kishte përcjellë, duke u thënë se akoma e kishte vajzën të vogël. Thoshte kështu, sepse atë ditë që u nis për në ushtri, i biri i ishte lutur:

— Baba, vetëm një amanet do të të lë. Mos vendos gjë për Vitën pa më pyetur edhe mua.

Ai e kishte puthur në ballë e i qe zotuar se askujt s'do t'ia jepte fjalën para se të merrte edhe pëlqimin e tij.

Kështu qenë ndarë me njëri-tjetrin. Po në ato ditë, një «telash» i ri e paskësh pushtuar fshatin e tyre. Thuhej se qenkësh mbledhur organizata bazë e Partisë e komunistët të gjithë në një mendje paskëshin vendosur për ngritjen e kooperativës. Po me gjithë dëshirën e shfaqur, vetëm dy i kishin familjet me vete, kurse dy të tjerët akoma s'i kishin punët në terezi me prindërit e tyre. Si njëri dhe tjetri u zotuan të bënin çmos për t'i bindur ata e për të dalë ballëhapur para fshatit.

Pastaj në organizatë u rrahën mendime se nga t'ia fillonin.

— Unë mendoj të bëjmë një mbledhje të popullit

në shkollë — tha njëri prej tyre. — Kush të regjistrohët, fitim e kemi. Veç kësaj, shembulli i atyre që do të hynin do të na hapte rrugën e suksesit e të bashkimit edhe për ata që do të mbeteshin pas.

— Jo, — kundërshtoi Telo Bani. — Bashkimi i tokave s'bëhet me konferenca e mbledhje të përgjithshme të fshatit. Me njerëzit në këtë rast duhet bërë një punë shumë e durueshme e duke u shtruar, sipas kohës e halleve, me secilin në veçanti.

Po shumica u bashkuan me mendimin e të parit: «Ç'humbasim po ta bëjmë?» Dhe ashtu u vendos: mbledhja të bëhej të pasnesërmen. Pastaj në organizatë u ndanë sektorët e punës.

Pothuaj të gjithë qenë të mendimit që Telo Bani të merrej me lagjen e Gremëve e të Sotajve dhe punën ta niste që nga Share Gremi.

— Gremët dhe Sotajt Telon shikojnë në sy, — tha një nga shokët e organizatës.

Pastaj edhe dy të tjerët theksuan se hyrja e Share Gremi kishte një rëndësi të veçantë për gjithë Ilirasin, mbasi ai nuk ishte vetëm baba dëshmori e komunisti, po edhe njeri i drejtë e i nderuar, që e mbanin në gojë jo vetëm fshati, po e gjithë krahina, me të dy krahët e Semanit.

Po ndërsa flitej kështu, Telo Bani ndjeu shqetësim në vetvete. Fytyra e plakut i doli para syve, po jo ashtu e qeshur dhe e ëmbël si gjithmonë, po e zymtë dhe e vrenjtur. Pastaj iu bë sikur Share Gremi i ngrysur i foli:

«Jazëk, more bir! Të kisha si Hysniun, e ti më godite pas krahëve në këtë mënyrë!» Ai përfytyrim e ngjethi dhe vetëm kur mblodhi veten kuptoi se gjatë atyre çasteve s'kishte mundur ta ndiqte bisedën e shokëve gjer në fund.

... Të nesërmen në mëngjes u bë edhe mbledhja e organizatës së rinisë. Në rendin e ditës kishte vetëm një pikë: ndihma që duhej të jepnin të rinjtë për ngritjen e kooperativës. Pas sekretarit, fjalën e mori e para Vita Gremi. Pastaj, duke diskutuar, të gjithë me radhë u zotuan se do të luftonin për ngritjen e kooperativës, duke nisur që nga familjet e tyre. Ashtu kaloi ajo mbledhje. Në fund, i kënaqur nga fjala e zjarrtë dhe premtuese e të rinjve, foli edhe Telo Bani, që kish marrë pjesë në emër të organizatës së Partisë.

* * *

Lloj-lloj fjalësh filluan të ndiheshin rreth bashkimit të tokave. Tani për të njëjtën çështje dy palë forca ishin vënë në veprim përballë njëra-tjetrës. Në njërin krah komunistët, me ririnë e ndonjë pa parti, e në tjetrin Bajram Gjatovili me Ethem Koburen, dhe Thimio Duçka, që kishte rënë në grackën e tyre, e disa të tjerë nga fisi e akraballëku i Koburëve e Gjatovilëve.

Midis tyre, Thimio Duçka, ndryshonte prej dy të parëve. Në të kaluarën ai renditej me më të këputurit e fshatit. Kurse ndryshe e kishin të kaluarën Bajrami dhe Ethem Koburja. I pari dikur si duaxhi e qehaja i Vrionasve, i përulur e i përvuajtur ndaj atyre që i njihje për zotër, kurse i prerë e i ashpër me ata që robtoheshin në tokat e tyre. Nga reforma i ishte prekur vetëm një lëndinë prej më pak se dy hektarësh. Megjithatë, mundahej të hiqej si njeri i këtij pushteti, që kishte vuajtur për bukën e gojës e që

vrionasit, si shërbëtor, e kishin rrjepur e shfrytëzuar si gjithë të tjerët. I dyti, Ethem Koburja, rridhte nga një familje e njohur agallarësh, të rënë nga vafti. Reforma s'e kishte prekur, po as i kishte dhënë ndonjë pëllëmbë tokë. Megjithëse ndryshe nga gjendja ekonomike, ai lidhjet e krushqitë gjithnjë i kish bërë me ta, duke i quajtur të tjerët me përbuzje, «lalë» e «rrjepacakë». Që në fëmijni ishte shquar si sherrxhi e grindavec dhe nuk u përtonte zënieve e mbërthimeve me të tjerët, edhe kur ishin më të rritur e më të fuqishëm se ai. Në ato kacafytje, mbasi u ngulte dhëmbët, e qetësonte gjaku që rridhte. Në fshat, megjithëse kishin kaluar vite, disa, si Hekuran Rexha e Temo Bani, babai i Telos, i kishin akoma ndër duar e ndër krahë shenjat e atyre dhëmbëve. Në 34-ën, kur ende s'i kishte mbushur të 21 vjetët, i futur nga Vrionasit, i kishte prerë kokën një kundërshtari të tyre. Gjyqi në krahinë e kishte dënuar me vdekje, pastaj, nga përkrahja që i qe dhënë, dënimi me vdekje i qe kthyer në 20 vjet burgim. Prej tyre kish bërë vetëm 28 muaj burg. Me ndërhyrjen e Vrionasve e kishin liruar pa e vuajtur dënimin e plotë. Krimin e dytë, për punë «hasmërie» siç e quante ai, e kishte kryer në shkurtin e 39-ës. Po para gjykimit vendi ishte pushtuar, dhe ai, duke përfituar nga amnistia e përgjithshme që bënë forcat italiane të pushimit, ishte lënë i lirë.

Përsa i takonte pjesëmarrjes në luftë nuk kishte marrë pjesë as me njërin as me tjetrën palë, megjithëse shpirtërisht ishte i tëri me Ballin, andej nga kishte dhe gjithë tarafin e farefisin e vet.

Ky ishte pak a shumë Ethem Koburja...

E ja tani edhe ajo mbledhja që pritej. U bë në një nga dhomat më të mëdha të shkollës. Po megjithë-

thëse ajo klasë ishte e gjerë dhe e gjatë, dyndja ishte aq e madhe, sa njerëzit qëndronin me të vështirë. Duke e hapur mbledhjen, një nga ata që kishin zënë vend në presidium ia dha fjalën Telo Banit.

— Shokë! — tha ai. — Para disa ditësh u ngrit edhe kooperativa e dytë tek ne. Kjo është rruga që hapi Krutja në rrethin e Lushnjes. Ajo që dallandyshtja e parë. Të tjera po duken në të katër anët e Shqipërisë. Ato flasin për rrugën që i tregon Partia fshatit në vendin tonë. Mendoj, shokë, se edhe neve na ka ardhur radha ta gëzojmë Partinë dhe veten, duke i bashkuar tokat dhe mjetet e punës! — dhe si përkroi një varg suksesesh të atyre pak kooperativave të para, Telo Bani u bëri thirrje të pyesnin për çdo dyshim a paqartësi që mund të kishin.

Pas një heshtjeje të gjatë, Thimio Duçka pyeti i pari:

— Toka jonë pjesërisht është zhavarë e një pjesë shëllirë. Po a mund të bëhet fjalë për kooperativë këtu, kur njerëzit, edhe më vete, siç janë, nuk arrijnë të bëjnë as bukën e gojës? Ja, këtë përgjigje desha unë! — dhe u ul.

Telo Bani e shënoi pyetjen.

Pastaj vazhduan pyetje të tjera dhe Teloja i mbajti shënim.

— Unë dua të di, — tha njëri, — a mund të ushqehen në kooperativë ata që janë krah i vetëm?

— Kurse unë pyes, — vazhdoi tjetri, — a ka ndonjë kooperativë që është prishur në ndonjë rreth, dhe si i kanë gjetur kufijtë e arave të zotët mbas prishjes së gjerdheve e të kufijve?

— Telo, bir! A hyjnë në kooperativë buallicat?

Dikush qeshi. Pastaj pëshpëritje u ndjenë në sallë.

— Shokë, — tha Telo Bani, — a ka edhe ndonjë tjetër që do të pyesë?

Askush s'u përgjigj.

— A ka edhe ndonjë tjetër?

— Përgjigjju! Përgjigjju pyetjeve që të bëri populli! — thirri Ethem Koburja rëndë. — Pa nga fundi i kam edhe unë nja dy pyetje për të t'i bërë.

— Shokë, — tha Telo Bani duke iu drejtuar masës, — kush nga ju dëshëron t'i përgjigjet ndonjërës nga pyetjet që u bënë këtu?

Befas një heshtje e thellë mbuloi sallën.

— Unë! — u dëgjua një zë vajze.

Njerëzit kthyen kokën në drejtim të krahut nga erdhi zëri.

— E ka fjalën shoqja Vita Gremi, — tha drejtuesi i mbledhjes.

Vajza e skuqur në fytyrë posa qe ngritur.

— Shokë! Më falni që po guxoj të flas për çështje të tilla para jush. Po unë do të them vetëm ato që i mendoj për të drejta e që i kam parë me sy në kooperativën e Shtukasit, jo shumë larg fshatit tonë. Nga pyetjet do t'i përgjigjem vetëm së parës: «A mund të ngrihet kooperativa edhe në një fshat si yni, ku ka një pjesë toke xhavarë e shëllirë?» E them që në fillim: unë s'besoj se ka tokë të lënë e të dobët, po ka krahë të lënë e të dobët. Ajo të jep aq sa t'i japësh. Kush ia bën hyzmetin më shumë e shpërblen më mirë, kush s'ia bën, e shpërblen pak ose aspak. Dikush i merr pesë, dikush njëzet e pesë. Po le ta zëmë se pjesërisht paskemi shterpë e shëllirë. A na e shkëmben njeri atë? Jo! Po sikur t'a punojmë si duhet, ta plehërojmë sipas nevojave që ka, po t'iu bëjmë bimëve të mbjella aty të gjitha shërbimet e duhura e me krahë të shumtë, t'ia marrim ujin Semanit e ta kaloj-

më në kanalën vaditës përmes saj, t'ua lëshojmë vendin parrmendat e drunjtat traktorëve, a nuk do të na japë më tepër nga ç'na ka dhënë? Kush nga ne s'e di si ishte më parë fshati i Shtukasit e sot kooperativa e Shtukasit? Kush nga ne s'e di se si ishin fushat xhavarë dhe shëllirë të atij fshati, ku as bari nuk mbinnte? Po le të shkojë kush dëshëron e t'i shikojë se çfarë u japin ato tani atyre njerëzve të bashkuar! Ja pra që s'e paska patur fajin toka! Kjo më kujton atë historinë e shpatës së Skënderbeut që kam mësuar dikur në shkollë. Një herë, një nga jeniçerët turq, duke e shikuar me cmir i tha Skënderbeut:

«Ti fiton, se shpata jote pret më shumë se çdo shpatë tjetër mbi faqet e dheut.»

«Atëherë, eja t'i shkëmbejmë!» — i tha ai. Jeniçeri i gëzuar pranoi. Pastaj filloi dyluftimi. Gjergji i madh, si gjithmonë, e shtriu edhe këtë armik. Kur i huaji po jepte shpirt, një nga miqtë e tij jeniçerë iu qas e i tha:

«Eh, or mik vëllai! Luftën s'e fitoka shpata, hekur i dheut, po krahu çelik i Skënderbeut!»

Kështu është edhe me tokën, prindër dhe shokë. Ja, unë këto kisha për të thënë.

— Më rrofsh, moj bijë! — tha Hekuran Rexha, që ndodhej pranë saj. — Fole pak, por sak.

— Kërcurja! — u ndie edhe një zë gruaje. — Duket që është çupë me shkollë...

Po vajza e skuqur flakë, as që i dëgjoji ato fjalë. Ajo u ul, duke shikuar me bisht të syrit njerëzit që kishin zënë vend në presidium, e veçanërisht Telo Bannin. Tani vetëm një brengë e mundonte: «A kishte folur siç duhej dhe ç'do t'i thoshte vallë ai, kur të takoheshin pas mbledhjes?»

Pyetjes së dytë, lidhur me «krahët e vetëm» në

kooperativë, kërkoi t'i përgjigjej Heke Rexha. Shembujt që solli qenë bindës dhe lanë mbresë.

Pastaj, Telo Bani, mbasi priti mos edhe ndonjë tjetër e donte fjalën, u dha përgjigje dy pyetjeve të fundit.

— Shokë — tha në mbarim, a ka pyetje të tjera? Në s'ka kush është pro ngritjes së kooperativës?

Dhe heshti.

— U shpejtove, Telo Bani! — u dëgjua një thirrje nga mezi. — E kam edhe unë një pyetje për ta bërë. Besoj se ta thashë që në fillim.

— Më fal, — tha djali — Thuaje, Ethem!

— Pra, dua të di dhe duam të dimë, or Telo Bani: a ka nxjerrë qeveria ndonjë dekret që ne t'i bashkojmë tokat me njëri-tjetrin?

— Jo, — tha tjetri nga presidiumi, — nuk ka nxjerrë.

— Po hyrja në kooperativë bëhet me zor apo me dëshirë?

— Vetëm me dëshirë.

— Atëherë ç'kërkon që na mbledh, gjersa ne, edhe herë të tjera ta kemi thënë copë? Apo si duket ti e disa si ti janë të papunshëm dhe kërkojnë të mbajnë pa punë edhe të tjerët?

— Mati fjalët! — tha me urti Telo Bani.

— Pse t'i mas? Nga frika apo për të të mbajtur nderin? Pra, folëm, po të them: me forcë apo me dashje?

— Ka të drejtë Ethemi! Ka të drejtë! Shpjegoja, Telo Bani, shpjegoja, me forcë apo me dashje?

— E thashë që në krye: me dashje, — u përgjigj rishtazi djali pa e humbur gjakftohësinë.

— E, po që me dashje, or lum miku, përse ta fus kokën në atë kularin tënd kur jam zot në tokën

time? Kur ngrihem kur dua në mëngjes? Kur punoj sa kam qef e kur kam qef? Kur shkoj ndër miq e rri sa të dua, pa i marrë leje njeriu, e pa i dhënë llogari njeriu? Kur... Kur... Kur... A mundet të m'i shpjegosh dot të gjitha këto?!

— Unë s'ngre këtu ndonjë çiflik për Telo Banin, or Ethem Koburja, — tha djali duke e humbur disi qetësinë.

Bajram Gjatovili u pre në fytyrë.

— Gomari! — mërmëriti me vete për Ethemin. — E kaloi masën e do të na prishë punë. — dhe ashtu i shqetësuar u mundua t'i bënte shenjë për t'u treguar më i përmbajtur me ato që po thoshte.

Po tani, Ethem Koburja e kishte marrë revan. Sytë e skuqur i qenë fryrë, kurse bota i dukej e tëra e tija. Dhe ashtu llomotiti e llomotiti sa mundi, duke thënë në fund: «I ke parë? I ke parë, Telo Bani, ato bretkocat që jetojnë nëpër pellgjet e ujit? Kur thahet njëri, ato hidhen te tjetri e, kur shterrin të gjitha, atëherë i vërsulen kënetës. Ashtu do të bëj edhe unë! Pellg më pellg e në fund te kënetë. E kur të thahet edhe ajo, atëherë do të dal në zall e do të përpëlitem, si ai peshku pa ujë, gjersa të më erren sytë... gjersa...»

Po befas një britmë qortonjëse e preu në mes njeriun që e kishte marrë me aq tallaz.

Njerëzit kthyen fytyrën andej. Bajram Gjatovili, i tronditur e i errur në fytyrë, qe ngritur në këmbë.

— Jo! Jo, Ethem Koburja! Jo ashtu! Nuk jam aspak dakord të ngatërrohen gjërat në këtë mënyrë! Këtu Telo Bani s'po ngre ndonjë çiflik për familjen e Banëve! Por, ashtu si nuk jam i një mendjeje me ty për ato që fole pa vend, ashtu nuk jam i një mendjeje as me Telon e shokët e tij, që kërkojnë medoemos

të bëhet e tyrja. Ti pyetjen e shtrove drejt. Dhe aty duhet të kishe mbetur: «Me forcë apo me dëshirë?» E gjersa kjo punë është me dëshirë, secili e di vetë në hyn apo nuk hyn. Unë he për he nuk jam për këtë rrugë. Rrethi ka 102 fshatra, kurse kooperativa ka vetëm dy. Le të bëhen 22 e 42, pa shohim e bëjmë pastaj. Kjo është fjala ime dhe kjo është edhe arsyeja që e ndiej veten të tepërt në këtë sallë e në këtë mbledhje.

Tani edhe Telo Bani, që njihej për gjakftohtësinë e tij, e kishte humbur qetësinë. Sytë i xixëllonin, ndërta gjaku i kishte hipur në fytyrë.

«I poshtri!» tha me vete duke e vështruar ngultas Gjatovilin e duke menduar se çfarë fshihej mbas atyre fjalëve të tij plot helm.

Po ky mendim shpejt iu pre në mes. Ethem Koburja, që akoma s'qe ulur, i bërë tym, e mori fjalën përsëri.

— Bajram! — tha i nxehur. — Mbaje për vete kritikën që më bëre. Kurse këtu s'jemi vetëm unë e ti që e ndiejmë veten të tepërt në këtë sallë e në këtë mbledhje, po një popull i tërë! Shikoji! Shikoji! Askush s'dëshiron të japë emrin. Askush s'është për këtë bashkim! — Dhe, duke u kthyer nga tarafi dhe akra-ballëku i Koburëve e Gjatovilëve foli:

— Vëllezër, kush nga ju s'është për këtë rrugë? Unë për vete po dal i pari . . .

Pa u shuar kumbimi i atyre fjalëve, një grumbull zërash u dëgjuan dhe salla buçiti:

— Të dalim!

— Të dalim, shokë!

— Të dalim!

Po Bajrami nuk thirri. Ai priti në heshtje, sikur të mos qe pjesëtar, e bile, kreu i atij komploti.

Pastaj, Ethem Koburja, si ndonjë dem i ndërkryer, priu. Dymbëdhjetë vetë, duke dalë nga bankat ku qenë ulur, ndoqën njëshkolonën. Pas tyre edhe pesë të tjerë. I fundit që po e mbyllte atë varg njerëzish të mashtruar ishte Bajram Gjatovili. Po kur kreu i njëshkolonës po i afrohej derës për të dalë, Heke Rexha, duke i rënë bankës me grusht, briti:

— Gënjeve, Ethem Koburja! Gënjeve kur the se asnjë s'është për këtë rrugë e për këtë bashkim! — dhe duke e ngritur edhe më lart zërin: — Telo, bir, — tha — shënoje emrin tim të parin përkrah ju katër shokëve të organizatës!

Në sallë u dëgjuan duartrokitje. Bajram Gjatovili në fund të atij vargu që po largohej, duke hedhur një sy mbi ata që po duartrokisnin, ndjeu një majë thike në zemër. Hyrja e Heke Rexhës, në ato çaste që ai me shokët e tij po largoheshin, hapte një shteg plot rreziqe.

«Plak gjysmak!» gjëmoi brenda vetes, duke e kaluar me tronditje e hutim atë prag dere. Pastaj porta u mbyll me një buçitje të fortë. Në sallë kishin mbetur vetëm 19 kryetarë familjesh. Ndërmjet tyre edhe plaku i Gremëve. I erdhi turp të dilte, megjithëse për atë vit kishte vendosur krejt ndryshe...

«Çudi! — tha me vete, duke i hedhur një sy sallës. — Sa pak paskan mbetur!»

Po jashtë, Bajram Gjatovili, kur pa se Share Gremi s'kishte dalë, u pezmatua.

«Po sikur ta kandisin dhe atë të hyjë në këtë bashkim të tyre?» mendoi dhe ashtu i tronditur mendja i fluturoi tek arat e tij, që kufizonin me ato të plakut të Gremëve.

«Ja kam frikën, — mendoi në heshtje — Mos e gënjejnë si pulën me krunde!»

Po ky shqetësim nuk zgjati. Dera u çel dhe njerëzit që kishin mbetur brenda filluan të delnin. Listës ku ishin shënuar emrat e të katër komunistëve dhe Heke Rexhës, pesë, i ishte shtuar edhe një. Por jo ai i Share Gremi.

— Lavdi zotit! — Me sa duket shpëtova, dhe kësaj here! — dhe pa ngurrim Bajram Gjatovili disi i çliroar i bëri shenjë të afrohej, Thimio Duçka.

— Shiko, — i tha. — Si nga ana jote, shko e zëre atë plak matuf. Me terezi preke në nder e në sedër. Thuaji se me sa të ka zënë veshi Telo Bani s'i ka mirë hesapet me të bijën. Thuaji se këto fjalë kanë filluar ngado nëpër fshat, thuaji se je prekur shumë kur i ke dëgjuar, thuaji se je matur t'ia thuash disa herë, po të ka ardhur rëndë e të është skuqur fytyra, e se tani, më së fundi, duke parë poshtërimin që po i bëhet emrit të tij të nderuar, vendose t'ia thuash që të gjitha. Në fund kërkoji ndjesë që e turbullove me këtë lajm të hidhur për të, për ty e për gjithë ne miqtë e shokët e tij.

Pas atyre fjalëve, duke ndërruar udhë, Thimio Duçka, si rastësisht, i doli përpara Share Gremi. Ai ia tha të gjitha. Në fillim i tregoi se diku kishin dyshuar rreth afërsisë së Vitës me djalin e Temo Banit e pastaj e këshilloi që kësaj së keqeje t'i dilte me kohë përpara, për të mos u lënë shteg gojëve të këqija për të dëmtuar, qoftë familjen e Gremëve, qoftë atë djalë aq të mirë e aq të nderuar.

Share Gremi, i bërë flakë në fytyrë, i ishte treguar mirënjohës.

«Bëra mirë që i fola me këtë gjuhë!» tha tjetri me vete, duke menduar lidhjet që kishin familja e Gremëve me atë të Banëve e sidomos dashurinë që

kishte ai plak për Telo Banin.

Kështu u ndanë.

Në mbrëmje, me t'u kthyer në shtëpi, Share Gremi thirri të bijën. Në fillim e pati të vështirë po pastaj fjala u shtrua.

— Dëgjo, moj bijë, — i tha. — Mos ma merr për ters. Ti e di: unë Telon e dua. Se vërtet është për t'u dashur. Jo vetëm si djalë i urtë e i zgjuar, po dhe si njeri i ndershëm e i drejtë. Këtë e thonë edhe ata që e duan edhe ata që s'e duan. Megjithëkëtë, kjo nuk ma lehtëson plagën që kam marrë, moj Vitë.

— Cilën plagë, baba?! — tha vajza me hutim e tronditje, duke u pezmatuar në fytyrë

— Do të të flas, moj bijë. Do të të flas. Asgjë nuk dua të të fsheh. — Dhe i menduar Share Gremi ia tha hapur ato që kishte dëgjuar, po pa e përmendur njeriun që i kishte folur pak më parë.

— Baba! — Po kjo s'është tjetër veçse një kurdisje nga njerëz që s'na duan!

Plaku s'u ndie. I heshtur thithi thellë cigaren që po i digjej ndër buzë. Pastaj:

— Sidoqoftë, — tha duke psherëtirë, — po u përhap fjala e keqe, hajde e pritja rrugën, moj çupë. Për njerëzit që s'e dinë tamam të vërtetën, është njëlloj sikur ta kesh bërë atë turp. Ja, për këtë të porosis: Mos e tako e mos i fol kurrë në udhë... Po edhe këtu, kur rastis që vjen, në të gjetë papritmas, përshëndete, jepi dorën dhe ik. Ja, kështu, pa i rënë në sy largimi yt e, në këtë mënyrë, pa na u marrë fytyra edhe neve përpara botës. Këto kisha, moj bijë. Në do të mirën e vetes dhe të mua plakut, sa të thashë vëri vëth në vesh! — dhe i zyrtë Share Gremi u ngrit e doli në oborr.

Po ndërkohë, atë mbrëmje, në njërën nga shtëpitë e komunistëve, edhe organizata bazë po merrte në analizë dështimin e asaj mbledhjeje . . .

Gjatë fjalës, duke bërë autokritikë, të gjithë i jepnin të drejtë Telo Banit, se bashkimi i tokave s'qenkesh nga ato punët që mund të zgjidheshin në një mbledhje të përgjithshme të fshatit, e se udha që u ishte dukur e shkurtër u kishte dalë shumë më e gjatë.

— Shokë! — tha Teloja duke folur i fundit. — Le të përpiqemi ta mbyllim sa më parë këtë plagë! — Dhe me hollësi përcaktoi detyrat e organizatës për ditët e ardhshme të asaj lufte, që tanimë ish bërë edhe më e ndërlikuar.

Pastaj mbledhja u mbyll. Po, nëse të tjerët fjetën, ai nuk bëri pikë gjumi gjatë gjithë asaj nate. Fytyra e Gjatovilit s'i hiqej nga mendja. Kurse të nesërmen edhe një goditje tjetër e ndoqi të parën. Vita Gremi, e tronditur, i tregoi bisedën që kishte pasur me të atin.

Që prej atij çasti bisedat e takimet e tyre në rruge mbarën fund.

Ishte një ditë e vrenjtur, më të dalë të shkurtit, kur një punonjës i aparatit të komitetit të Partisë erdhi në fshat dhe mori pjesë në një mbledhje të organizatës bazë. Të nesërmen, zëra të ndryshëm u dëgjuan në katund. Dikush thoshte se kishte ardhur nga qendra e dikush nga rrethi, po si të parët ashtu edhe të dytët nuk e dinin mirë qëllimin e të ardhurit. Megjithatë me hamendje njerëzit filluan të flisnin po-

shtë e përpjetë. Kështu, disa thoshin se kishte ardhur për prishjen e gjerdheve, disa thoshin se kishte ardhur për sistemimin agrar e të tjerë për ngritjen e kooperativës në fshatin e tyre të vogël. Po si për çudi, të nesërmen, i deleguari, siç e quante fshati, s'u duk më gjëkundi. Veçse ajo fjala e fundit mori udhë nëpër katund. Njerëzit, duke pyetur për të ardhurin, me vend e pa vend, e hidhnin fjalën te ngritja e kooperativës. Me ato mendime në kokë, i vetëm i shqetësuar, Gjatovili zbriti te fusha e Zhavarës. Pranë asaj fushe të vogël shtriheshin arat e tij: kumet e kallmet. E aty pranë edhe lëndina e korijeve, gjithë-gjithë 16 dynmë tokë. Dikur edhe ajo kishte qenë e tija, po tetë vjet më parë, kishte ndërruar zot... Nejse, kishin shkuar si kishin shkuar ato ditët e «hidhura» të Reformës Agrare, po këto të tanishmet po i dukeshin më kiamet. I bëhej sikur një re e zezë i qëndronte vazhdimisht mbi kokë. Dhe ja, pikërisht për këtë, tërë ato ditë, rrallë kish vënë ndonjë kafshatë bukë në gojë. Vetëm me duhan e raki e kishte menduar ta shuante atë helm që po i brente zemrën.

«Eh, or Telo Bani! Ke për të më parë ndonjë ditë! Por dije ama, dije, or djall, se s'ke për t'ia dalë mbanë! Më thonë Bajram Gjatovili mua...»

Po sado që mundahej ta ngushëllonte veten, prapë në heshtje lloj-lloj mendimesh ia ndrydhnin zemrën.

«O perëndi! Po sikur me të vërtetë t'ia dalin mbanë?» Po sikur nesër të shemben gjerdhet e të ngrihet kooperativa e tyre? Zot na ruaj, po ç'kooperativë të bësh me reckamanët e fisit të Rexhëve? Arat e tyre janë më të varfra se leckat që u mbulojnë trupin!»

Dhe prapë, pa gjetur udhëdalje, vinte grushtat në

tëmtha e psherëtinte, pa i larguar nga sytë as Telo Banin e as atë plakun e Rexhëve që po i vinte flakën shtëpisë së Gjatovilëve.

«Eh, or Heke Rexha! Si s'të rregullova atëherë kur të zuri Balli. . . Më shpëtove,, më shpëtove si ngjalla, or qen i qenit! . . .» dhe përsëri psherëtinte duke e vështruar me brengë atë ball toke që pjesërisht mbulohej nga gjelbërimi i të lashtave e pjesërisht prej uga-reve të pranverës.

«Çfarë gruri! — tha me vete dhe ngadalë iu af-rua asaj parcele. U përkul, i ledhatoi ata kallinj të gjelbërt pastaj një pëshpëritje i doli nga buzët:

«Toka ime! Unë kurrë, s'do të të lëshoj nga du-art!»

Po ky gëzim nuk zgjati. Papritmas iu duk sikur akoma Telo Bani dhe Heke Rexha po përqafoheshin me njëri-tjetrin e të tjerët, të rrëmbyer nga ky gëzim, po duartrokisnin.

— Eh, e mori dreqi e mori! — tha i ngrysur në fytyrë. Pastaj, me atë brengë në zemër, u ktheu krahët arave të tij e ngadalë u drejtua për nga shtëpia. Tani edhe dielli i asaj dite s'dukej më. Të mugëtit e mbrëmjes dalngadalë kishte pushtuar Ilirasin e tërë kra-hinën përfaq.

*

*

*

Qenë të rënda e të vështira ato ditë për Gjatovilin. Po edhe më të rënda e më të vështira orët e atyre netëve. I kujtohej kur ishte i parë e pyetej për gjithçka në fshat, kur sofrën ngado që shkonte e gjente shtruar, kurse tani as që pyetej e as që përfillej nga njeri.

Këto kujtime ia lëndonin e ia mundonin zemrën e ai, si peshku në zall, rrotullohej në shtrat sa nga e majta nga e djathta. Po as andej e as këndeje nuk gjente prehje e qetësi.

«Po në u bëftë e tyrja?»

Dhe kjo tronditje i bëhej edhe më e madhe kur i shkonte mendja te Gremët. Arat e tij kufizonin me ato të Shares. Po të hynte ai, toka pjellore e Gjatovilëve vihej në rrezik, sipas mendimit të tij. Kooperativa, duke formuar bllokun e saj, do ta shpërngulte që andej. Sigurisht pa tokë s'do ta linin, po ndryshe ishte ajo e tija, e shumë ndryshe ajo që do t'i jepnin.

Duke menduar kështu vendosi ta çonte gjer në fund atë që s'kishte arritur me Thimio Duçkën.

«Jo, — mërmëroi me vete si i çliruar nga ajo brenge, — Share Gremin s'do t'ua lë të bashkohet me ju!» — dhe menjëherë u ngrit e ndezi çibukun, duke përpunuar në kokë grackën që do t'i kurdiste fqinjit.

Mbas mesnate, vonë, nga lodhja e pagjumësia, qepallat i mbyllën dalngadalë, po para syve përsëri i kaluan me radhë arat e Share Gremit, që kufizonin me ato të tijat; e pastaj prapë iu faneps ai plaku i Rexhëve duke u përçafuar me Telo Banin e, më në fund, edhe ai grumbull njerëzish duke rrahur shuplakat e duke brohoritur për hyrjen e tij në kooperativë. Papritmas ajo zhurmë e hodhi havadan mbi shtrat. Po kur hapi sytë, pa fëmijët që flinin të qetë e përbri tyre të shoqen me djalin e vogël pranë.

«Çudi, — pëshpëriti ngadalë. — S'paskam bërë asnjë sy gjumë! — dhe u ngrit e doli para se të dilte dielli mbi majën e zbardhur të Tomorit.

Mbrëmje. Një hije e zezë e kishte mbuluar fyty-

rën e Share Gremi. Ashtu i ngrysur, vuri qetë përpara e mori udhën në drejtim të shtëpisë. Po fytyra e së bijës ende i qëndronte përpara syve.

«Eh, eh, moj shtrigë!» psherëtiu papritmas dhe rishtazi ndjeu se ajo dallgë zemërimi po tërbohej në shpirtin e tij të lënduar.

«Ashtu është!» tha më së fundi me vete dhe, duke u dhënë hak fjalëve të botës, përsëri i doli përpara syve Bajram Gjatovili. Iu duk sikur akoma qëndronin këmbëkryq tek ajo mezhda e kumeve. Bajrami duke i folur e ai i zyrtë duke e dëgjuar në hesh-tje.

«Kështu, or Share vëllai, kështu! Sikur më zuri dheu nën vete kur dëgjova për tët bijë. Se e mira ndoshta s'të zë, po turpi i mikut të zënka, or vëlla!» Këto fjalë ia errën vështrimin dhe pa e kuptuar, Share Gremi shpejtoi hapat në drejtim të shtëpisë.

— Grua! Grua, moj! — thirri me të hyrë në oborr dhe pa pritur përgjigjen e saj prapë klithi me zemërim.

— E po ku je, de, që mos qofsh!

— Ja, ja, dola, — thirri ajo që nga koçeku dhe, duke shpejtuar, vrapoi drejt tij.

«Diç do të ketë!» mendoi, po për ta pyetur s'guxoi të hapte gojë, veçse pa fjalë futi qetë në gra-zhd e prapë u kthye në konak me një krah shkarpa në duar. Ashtu, pa fjalë, ndezi zjarrin, duke i hedhur ndonjë sy vjedhurazi të shoqit. Po Share Gremi as që e kishte mendjen tek ajo. Me buzë e vetulla të varura, ai nxinte si kllaniku i asaj vatre. «Ç'të ketë ngjarrë?» tha gruaja me vete dhe papritmas mendja i shkoi te ndonjë fatkeqësi a vdekje. «Qyqja, se kam dhe djalin larg!» Duke u rrëqethur ngriti kokën dhe e vësh-

troi drejt të shoqin, që pothuajse pa ndërprerje thëthinte çibukun e lëshonte nga hundët avuj të bardhë.

Ai vazhdoi në heshtje fillin e mendimeve të tij e përsëri iu bë sikur i pëshpëritën në vesh ato fjalët therëse të Bajram Gjatovilit.

«Më mirë të më kishte vdekur ndonjë nga femijët, or Share, se sa të dëgjoja kështu për çupën tënde! Eh, si më erdhi, or vëlla, se u bëra kaq e gjer më dje asnjë fjalë e keqe s'qe dëgjuar për fisin e Gremëve! Bile bota thoshnin: Gremët janë të varfër, por për nder ama, askush s'ua del në tërë Myzeqenë! Kurse tani, për të zezën tënde dhe tonën, çupa jote flitet se me ata të organizatës...»

— Të organizatës?! — kishte pyetur me hutim e tronditje Share Gremi.

— E po, me të birin e Temo Banit, Share! — ia kishte kthyer urtë Gjatovili duke ndier një gëzim të thellë nga pikëllimi e turpi i plakut.

Veçse atë fytyrë e kishte fshehur me kujdes. Pastaj, për t'i humbur gjurmët edhe më fort, kishte pshe-rëtirë aq thellë, sa që Share Gremi i qe dukur çdo fjalë e tij e drejtë dhe e dalë nga zemra.

Po Gjatovili, duke përfituar nga rasti, përsëri kishte vijuar:

Kështu, or Share! Dhe hajde pastaj, të kam rixa, të bashkohesh me këta bukuroshë! «Ah sa të ngrihet ajo e shkretë i kish thënë Teloja një shoku të vet, pa pastaj di unë se si i ndërroj gratë e çupat e këtij fshati: ja, si ai gjeli pulat!» Tjetri kishte qeshur e i kishte thënë: «Ah, drej o Telo, po pse s'të paska mjaftuar, or lugat, Vita e Share Gremi?» «Vita!? E ç'Vitë, more i shkretë?... Kurse tani... tani e kam qepur syrin gjetskë, or lum mik!» «Po Vitën, — i kishte thënë tjetri — ç'do ta bësh, apo do ta çosh me

të tretë?» «Po dhe ashtu mund të ngjasë» ia kishte pritur Teloja dhe që të dy ia kishin shkrepur një të qeshuri sa që lot u kishin shkuar nga sytë.»

— Ma lërofsh, or Telo Bani, — kishte shfryrë me gjëmim plaku i Gremëve, ndërsa sytë po i lëshonin shkëndija nga tërbimi.

— Mos prish gjakun! — ia kish kthyer me urti Gjatovili. E mos ia merr për ters, se është djalë i zgjuar e s'e ka vetëm me tët bijë. Vetëm më vjen keq se këtu te ti, si njeri i besimit e djalë shtëpie, s'duhej t'i kishte futur hundët.

Plaku i Gremëve që bërë qymyr në fytyrë e nuk kish kthyer përgjigje.

— Përse hesht? — kishte vazhduar tjetri si me dhembje. — Iku koha e heshtjes, Share! Tani ka ardhur çasti t'i bëhemi krah shoqi-shoqit. Po u thye njeri, vate edhe tjetri. E more vesh? Ja përse duhet të zëmë duart e t'i qëndrojmë këtij rrebeshi. — Dhe në çast që betuar se ai gjer në vdekje s'kishte për t'i dalë asaj fjale.

— Ja! — kishte thënë më së fundi, duke shtrirë krahun. — Eja të shtrëngojmë duart! Këtë e bëj më shumë për ty se sa për vete. . . Për nderin e satë bije. Po dhe për nderin e sime bije, se dhe asaj mund t'i ndodhë nesër ajo që i ndodhi Vitës sate.

Në atë tronditje Share Gremi, i turbulluar, pa e kuptuar dhe ai vetë kishte shtrirë krahun e i kishte dhënë dorën.

Pastaj Gjatovili i gëzuar e kishte përqaftuar duke i pëshpëritur ngadalë.

— Ti je vërtet burrë, Share Gremi! Unë isha i bindur se s'do të bije kurrë në lakun e atyre lapanjözëve.

Ky kishte qenë muhabeti që kishin këmbyer me

njëri tjetrin, e tani i kujtoheshin rishmë ato fjalë, e herë i zbehej e herë i skuqej fytyra.

Nënë Dëlja ziente përbrenda. S'dinte si të bënte. «Diçka e keqe do të ketë ngjarë e ndonjë sherr i madh do të plasë!» mendonte.

Nga këto mendime e shkëputi plaku, që atë çast e urdhëroi të thërriste të bijën.

Me zemër të dridhur ajo u ngrit e doli në hajat e që andej thirri:

— Vitë! Vitë, moj!

— Urdhëro, nënë! — u dëgjua që matanë zëri i kthjellët i së bijës.

— Eja, eja, moj bijë!

Vajza la punët e vrapoi në konakun e t'et. Përshëndeti e qëndroi në këmbë, duke pritur. I ati, ashtu i ngrysur, pas disa çaste heshtjeje e vështroi vrazhdë:

Ajo e ndjeu atë gjëmë.

— Thuamë, ç'ke bërë gjer më sot prapa krahëve të mi me Telo Banin?

Vajza ngriu. Nëna u drodh nga ato fjalë e mendja në çast i shkoi tek i biri e tek ajo mbrëmja e fundit para se të nisej për në ushtri, kur ai tërthorazi i pat zënë ngojë diçka për Vitën dhe Telon.

Po zëri i vrazhdë i plakut përsëri gjëmoi e gruaja iu shkëput atij vegimi.

— Thuamë! — bërtiti ai edhe më fort duke iu drejtuar për së dyti së bijës. — Ç'ke bërë me të? Po dua të më flasësh hapët, ama! More vesh? Hapët!

Buzët e holla të vajzës u drodhën.

— Fol, fol! — ngulmoi sërish. — Veç hapët! Hapët të thashë!

— Si urdhëron — tha ajo e zbetë dhe e ngrirë. — Hapët do të të flas, baba. Hapët. Ai s'është njeri dokudo, po komunist dhe sekretar i organizatës.

— E mora, e mora vesh se ç'sekretar është ai pusht, po thuan ç'keni bërë bashkë prapa krahëve të mi!... — dhe në çast sytë e tij shkrepëtinë nga ai zemërim i papërmbajtur që po i shtrydhte zemrën aq keq.

Ajo u drodh, duke ndierë rrebeshin që po afrohej.

— Baba — tha — ai nuk është ashtu si po thua, po një nga djemtë më të mirë në këtë fshat. Ai është shok i Hysniut e i Cenos... Ai...

Siii!? Guxoke edhe të ma lavdërosh?! Edhe të ma krahasosh me tim bir, që më ka tharë sytë, që më ka djegur shpirtin?

— Unë po them vetëm të vërtetën, baba! Këtë e thonë të gjithë. Këtë e ke thënë edhe ti vetë sa herë që ka rënë fjala për të.

— Të vërtetën? Ti po më flet për të vërtetën? Ti, që i vure vulën e zezë shtëpisë së Share Gremit? Ti, që nxive emrin e tyt vëllai? Ti që...

E duke u ngritur ia vuri të dyja duart në fytyrë.

— Fol! Fol! O tregomë ç'ke bërë me të, o përdryshe të mbyta mu këtu në vend!

— Mbytmë! — tha vajza e zbetë, po e palëkundur në qëndrim. — Mbytmë! Veçse para mbytjes, një gjë duhet të dish: as ai as unë nuk i kemi faj njeriu. Në është për faj, ne kemi vetëm këtë faj, baba... Vetëm...

— Ashtu? Atëherë fol! Fol! Çfarë faji keni ju? Çfarë faji keni ju?

Po ajo nuk mundi të hapte gojë. Zemërimi i t'et kishte arritur kulmin. Duart e tij të forta, duke e shtrënguar për fytyrë, e ngritën përpjetë e pastaj sa gjatë gjerë e përplasën përdhe duke ia përpjekur kokën

në vatër e pastaj duke i rënë fytyrës me tërë fuqinë e atyre krahëve të bërë hekur nga puna.

Nga hundët e vajzës shpërthyen dy rëkera gjaku. Nëna e lebetitur klithi e u derdh në ndihmë të së bijës duke e shkëputur nga krahët e fuqishëm të të shoqit. Ai desh ta shtynte e ta qëllonte edhe atë, po gjaku i Vitës, që i kishte lyer duart, ia theu zemrën dhe papritmas e bëri të zbrapsetj i ligështuar.

— Jazëk, jazëk! — u dëgjua me tronditje zëri prekës i nënës e pastaj lot u dukën në sytë e saj të zgurdulluar.

— Vitë! — i tha, duke e marrë në mbrojtje. — Do ta kenë yshtur bota, moj bijë!

Po vajza nuk foli. Ajo u ngrit, e, sikur të mos kishte ngjarë gjë, prapë i hodhi një vështrim të atit, sa të qetë, aq edhe keqardhës, dhe ashtu, e heshtur, i ktheu krahët atij konaku përdhes.

Kështu ngjau. Pastaj Share Gremi i vetëm nxori pagurin e piu për ta shuar atë helm që po i digjte kraharorin.

Të nesërmen, Heke Rexha, si anëtar i këshillit, i pruri fletën e detyrimeve ndaj shtetit.

— Pse s'erdhe mbrëmë në mbledhje? — e pyeti Hekja.

— S'isha mirë — iu përgjigj tjetri, që i kish dalë fare nga mendja ajo mbledhje. Pastaj kërkoi që t'ia këndonte ato dy satër fjalë që shkruheshin në atë letër.

— 7 kv grurë, 2 kv mish, 13 kg lesh, 280 vezë dhe 38.000 lekë tatim.

— 38.000 lekë?

— Po. Kështu shkruan. Më 15 mars paguhet kësti i parë... Vetëm në kooperativë s'ka tatime e detyrime, Share...

Po Share Gremi s'i ktheu fjalë.

Të nesërmen, kur plaku i Gremëve kishte dalë aravë, dikush trokiti në portën e tij.

— Kush është? — pyeti plaka.

— Jam unë, nënë Dile, — u dëgjua zëri i hollë e tingëllonjës i Lumtëri Banit, i Lumtës, siç e përkëdhelte ajo.

Gruaja i hapi derën dhe e drejtoi nga konaku i së bijës.

— Vita sot u gdhi pa qejf, moj Lumtë!

— Pa qejf? — tha vajza me shqetësim.

— E po helbete, të gjallë jemi, moj çupë! — dhe me rrëqethje kujtoi të mbrëmshmen dhe atë gjak që mbuloi fytyrën e së bijës.

Pas pak, të dy vajzat, kur gruaja doli, ranë në krahët e njëra-tjetrës.

— Vitë! Po ti djeg, moj xhan!

— Po, — tha tjetra, — kam pak temperaturë, Lume!

— Po duke shqiptuar këto fjalë, ajo s'mundi t'i mban-te lotët.

— Vitë! Vitë! — tha Lumja e tronditur. — Pse po qan?

Tjetra s'u përgjigj për një çast, pastaj, pa u ndarë nga krahët e saj, i tregoi tërë historinë që i kishte ndodhur.

Në fund, duke nxjerrë një letër:

— Jepja Telos, — i tha, — dhe thuaji të ketë kujdes veten në këto ditë! Më kupton, besoj.

Tjetra pohoi me krye dhe u ngrit për të dalë.

Që prej atij çasti Lume Bani u bë ndërlidhësja dhe njeriu i tyre më i afërt.

«Telo! — i thoshte ajo në letër, — Mos u shqetëso për këto që po të shkruaj. Ndoshta do të ishte më mirë që të mos i dije, ndofta do të ish edhe më mirë që unë të heshtja e ta mbuloja atë që ndodhi mbrëmë... Po e

ndiej se nuk mundem. Dikuj duhet t'i hapem. Dikuj duhet t'ia them të gjitha. Po kujt, përveç teje? Pra, dëgjo! Mbrëmë ndodhi një e papritur që më tronditi rëndë. Im atë s'ish më ai Sharja i qetë dhe i urtë, siç e njohin të gjithë. Po një njeri tjetër, i panjohur gjer më sot edhe nga unë që jam bija e tij. Ah, ta shihje, çfarë brenge ia mundonte zemrën! Ta shihje, ta shihje si i mbërtheheshin vetullat mbi ata sy të ndezur flakë! Sigurisht, njerëz të këqij do të kenë bërë punën e tyre. Kushedi se çdo t'i kenë folur për ne të dy. Ai s'm'i tha të gjitha, veçse me tallaz më shtrëngo t'i tregoja se ç'gjë të papëlqyer ishim duke bërë bashkë «fol, fol moj nepërkë!» më kërcënohej. Kurse ty të quante njeri të pandërshtëm dhe shkelës të miqësisë dhe të besimit që të kishte dhënë. Tha edhe fjalë të tjera, po më vjen rëndë t'i zë ngoje, e aq më tepër të t'i shkruaj në këtë letër.

Falëm për këtë dhe mëso se kur unë fola mirë për ty, ashtu siç është e vërteta, ai u egërsua aq shumë sa më goditi dhe më përgjaku rëndë . . .

Rrashë pa nxjerrë asnjë fjalë, asnjë britmë. Veç, e heshtur e me lot në faqe, u largova e ndihmuar nga nëna. Po ndër sy edhe në ato çaste të vështira të kisha ty. Ty, duke më shikuar me dhimbje e duke më thënë: «Duro, Vitë! E drejta është me ne».

Dhe unë ashtu bëra. Durova në sytë e tim eti, po në zemër ndjeva hapjen e një plage të madhe. Tani, gjithshka është prishur midis atij dhe neve. Vetëm nëna, më ndihmoi me sa mundi. E tronditur nga gjaku që më kish mbuluar u derdh e më tërhoqi nga duart e tij.

Ja, kështu ndodhi. Pastaj unë shkova në konakun tjetër e atje u përplasa në një qoshe, ku qava e qava sa munda. Besoj, lumi fjeti mbrëmë, po unë jo.

E në atë gjendje herë-herë më shfaqej im atë i egërsuar, duke u derdhur sipër meje, e herë-herë ti, duke më thënë me bindje: «Asnjëri s'do të mundet të na ndajë, Vitë!» Unë e kam të plotë atë besim, Telo. Sidoqoftë, tani për tani e vetmja udhë lidhjeje për ne të dy mbetet Lumja. Unë hë për hë s'kam mundësi të dal jashtë. Edhe për shkak të gjendjes shëndetësore, po edhe për shkak të urdhrit të tim eti. Të paktën për një farë kohe, sa t'i kalojë ky zemërim, që e ka shndërruar në një tjetër njeri.

12 mars 1953

Të fala
Vita»

«E mora letrën tënde. Sa ndryshon ajo nga të tjerat! E lexova dhe e rilexova disa herë e në fund një goditje të fortë ndjeva në zemër, Sa keq, thashë me vete, që ka edhe njerëz të tillë, si ata që i kanë prishur mendjen tyt eti! Po tek e fundit, Vitë, pse të çuditemi? Ku vanë ata që dje na luftuan me armë? Ata që u goditën nga reformat? Ata që u deklasuan e që sot njihen si armiq klase? Po edhe të tjerë, që ndofta akoma s'e kanë marrë këtë vulë, po që me zemër janë kundër këtij pushteti e këtij populli, njerëz që hedhin gurin e fshehin dorën? S'di sa më jep të drejtë, po unë gjithnjë dyshoj tek Ethem Koburet e Bajram Gjatovilët me shokë, megjithëse në dukje mundohen të hiqen si njerëz që na e duan të mirën. Kam bindje të plotë se nuk jam i gënjyer për dyshimet e mia dhe jam i bindur se ata nuk e kanë hallin te ne, po nëpërmjet nesh rrahin të largojnë tët atë nga udha dhe thirrja e Partisë... Rrahin për të minuar ngritjen e kooperativës.

Ja, ky është synimi i tyre, sipas mendimit tim. Sidoqoftë, e ardhmja do të na flasë edhe më qartë rreth qëllimit të kësaj goditjeje të papritur.

Tani, vetëm një këshillë kam për ty: të qëndrosh e fortë! Të mendosh se në çdo moment ke Partinë me vete e se, jashtë mureve të asaj shtëpie, jeton e punon edhe një njeri që të do e të pret, që vuan e mendon bashkë me ty, që lufton e beson se asgjë s'do të mund ta ndali fitoren e së drejtës. Ky njeri jam unë. Kaq për këtë herë.

13 mars

Të përshëndes
Teloja»

«Të jap të drejtë përsa më shkruaje. Veç më vjen keq që s'më përmendje gjë rreth punës që jeni duke bërë. Vetëm Lumja diçka më tregoi me gojë e unë me vëmendje e dëgjova gjer në fund. Do të dëshëroja që të gjitha hollësitë e kësaj lufte në ditët e ardhme t'i mësoja nga ti. Besoj se s'do të kursehesh. Shokëve shumë të fala.

15 mars

Jotja
Vita»

«U gëzova shumë që ti e ke mendjen te puna që po bëjnë shokët e shoqet e tua. Po nga ana tjetër ndjeva dhembje në zemër, që në këtë betejë ti akoma nuk je midis nesh. Sigurisht, për shkak të sëmundjes, se përsa i përket vendimit të babait, ai nuk është i drejtë dhe me të unë besoj se mund të merret vesh e ta bindë organizata e Partisë dhe këshilli i fshatit. Sidoqoftë kije kujdes shëndetin dhe mundohu t'i lar-

gosh mendimet e këqija. Vetëm ashtu do të mund ta marrësh veten sa më shpejt. Ti s'duhet të harrosh se puna jonë nuk ka mbaruar. Ky është vetëm fillimi. Po ne kemi edhe shumë për të bërë. Në atë që mбетet ti ke pjesën tënde, së cilës unë besoj se do t'ia dalësh me nder, siç ia ke dalë gjithmonë.

Tani mëso se punët tona nuk venë mirë! Nga të 37 familjet që ka fshati, vetëm 6 janë për kooperativën. 4 komunistët dhe Hekuran Rexha, me të nipin 6, i cili flet më shumë se komunistët për të mirat e kësaj pune. Po çështja është mbërthyer keq. Gjato-vilët dhe Ethem Koburet, me sa kuptoj unë, kanë punuar me mend. Ata kanë zënë kyçet e punës dhe akoma vijojnë të punojnë në këtë drejtim. Po dje ndodhi diçka krejt e papritur për mua dhe shokët e tjerë të organizatës. Ti e njeh Dine Skurajn. Si gjithnjë, mbasdite ishim mbledhur te sheshi i shkollës. Ne të katër dhe xha Hekja, pesë. Po qanim hallin se ku na ka mbetur sharrë në gozhdë. Në këto çaste hequr mënjane më zuri syri Dinen. Rrinte i menduar dhe i drojtur. Kur vuri re se e vështrova për të dytën a të tretën herë, u ngrit për t'u larguar.

— Ku vete? — i thirra dhe i vajta pranë.

— Në shtëpi, — m'u përgjigj i mërzitur.

— Po pse largohesh? — i thashë. — Njerëzit në moshën tënde duhet t'i hapin udhë vetes...

— Eh! — psherëtiu. — Po të mos kishte bërë im vëlla atë që bëri do të qe ndryshe... Po tani është vonë, or shoku Telo!

— Vonë?! Po pse është vonë?

— Mos luaj, — tha me dhembje, — mos luaj me plagën që kam marrë. Ti e di se si rinia e një fshati të tërë u ngrit kundër tim vëllai. Nga vajti e e gjeti dreqi bijën e një njeriu të deklasuar! Ç'më duhet, pas

kritikës ia la të mallkuarit çupën, po vetes dhe mua na la njollën!

— S'është ashtu, — i thashë, — ai e la e ajo tani me dikë tjetër nga sëra e saj, është martuar kurse yt vëlla atje ku punon është punëtor i nderuar.

— Shoku Telo, — më tha, — flet kështu për të më bërë qejfin, apo për të lozur me fatkeqësinë që më ka pushtuar?

M'u dhimbs, Vitë.

— S'tallem, — i thashë me një theks të prerë, që të më besonte. — Ti edhe atëherë e dënove fejesën e tij me atë vajzë. Dhe organizata dhe fshati e dinë mirë atë që bëre.

— Si? — tha ai tepër i hutuar. — Po a e di ti se me ç'sy më shikojnë mua që nga ajo ditë? E pastaj, edhe ajo mbledhja ku fshati goditi jo vetëm atë, po edhe ne si familje, që kishim mbyllur sytë e kishim lejuar që ai të binte në atë batak!

— I di — i thashë. — I di të gjitha. Po ajo që vetëm një kritikë dhe jo mbyllje dere, ose vrasje për njerëzit tanë. Yt atë ka qenë partizan dhe fshatar i varfër. U kthye me plagë nga lufta dhe vdiq si njeri i nderuar dhe i Partisë. E të sajët jeni edhe ti edhe yt vëlla. Ndaj dhe e kritikua kur desh të bashkohej me një vajzë që ishte e huaj për të si klasë.

Atij iu drodh buza dhe më shikoi me habi në sy, sikur të desh të zbulonte në i kisha a s'i kisha me gjithë mend ato fjalë.

— Pse çuditësh? — e pyeta — Ty të takon të vazh-dosh rrugën e babait. Të punosh për këto ditë! Dhe të punosh shumë. Kjo është detyra! E jotja dhe e ne të gjithëve . . .

S'foli, po sytë ia pashë të mbushur me lot.

— Shoku Telo — më tha — a mund të të hapem

për diçka, po mos ta bësh për fjalë, se padashur mund të më dëmtosh?

Dhe a e di se ç'më tregoi, Vitë? Bajram Gjatovili dhe Ethem Koburja, sot në drekë e kishin qëlluar dhe e kishin përgjakur, se e kishin gjetur tek po u fliste Lazër Gorit dhe Serjan Dedës për të mirat e kolektivizimit, duke u sjellë shembull sukseset e një kooperative në një rreth tjetër, ku ka të afërmit e vet nga nëna.

Pas kësaj goditjeje, duke e sulmuar Dinen si armik të Partisë e familje të deklasuara, Gjatovili e Koburja, kishin zbratur gjithë thesin e urrejtjes së tyre kundër kolektivizimit. Nejse, hollësisht do të t'i shkruaj më vonë. Tani, mjafton të dish se për ne bëhet edhe më e qartë se kush na lufton e kush janë në të vërtetë Bajram Gjatovilët dhe Ethem Koburet, që për sy e faqe na hiqen si njerëz të mirë. Siç e kupton, Dinia na ndihmoi këtë radhë e, në të ardhmen, me porosinë që i dhashë, besoj se do të na ndihmojë edhe më shumë. Ata nuk dyshojnë prej tij, mbasi e quajnë si një njeri të goditur e të braktisur plotësisht prej nesh. Kaq për këtë herë. Shokët të përshëndesin që të gjithë.

17 mars

Teloja

«Më preku shumë letra që më dërgojë. Ah, që s'jam midis jush. Megjithatë kjo barrikadë do të kalojë dhe unë shpresoj se ajo ditë s'do të jetë e largët. Askush s'do të mundet të më pengojë. Them kështu, sepse unë kam besim tek Partia, tek vetja dhe tek ti, Telo! Po edhe tek im atë. Ai s'është njeri i keq, po e kanë yshtur ligisht, shumë ligisht. Një ditë, pa tjetër, do ta kuptojë se midis nesh s'ka asgjë të pra-

pësht! Veçse, për një gjë më vjen keq: që s'munda ta prisja ashtu siç kisha ëndërruar këtë pranverën tonë të parë... Por ajo porsa ka ardhur e unë tani, shpirtërisht, e ndiej veten mjaft më mirë. Veçse për këtë kthesë të jam mirënjohëse ty. Këshillat e tua marritën besimin në vete. Tani edhe jetën më duket sikur e shikoj ndryshe. Duke t'i shkruar këto radhë, Dinia s'më hiqet nga mendja. I shkreti djalë! Në të vërtetë për të kjo është rilindje, Telo. Ai s'do ta harrojë kurrë këtë ditë e as ty, që i pari i dhe dorën dhe e ftove si shok në këtë betejë...

Tani mëso se edhe unë sot jam më mirë me shëndet dhe më e qetë. Më pëlqen të dëgjoj se ç'bëjnë të tjerët dhe aq më tepër të lexoj vepra ku heronjtë përballojnë çaste të vështira. Dje e nisa për së dyti romanin «Si u kalit çeliku». Me të vërtetë, Telo, ai Pavli ka qenë njeri i mrekullueshëm! Çfarë guximi e çfarë besimi ka pasur tek vetja e tek Partia! «Ja, këtij i thonë njeri» them me vete. Dhe, duke lexuar ato fletë, më duket se edhe unë e ndiej veten më të fortë e më të gatshme për t'i bërë ballë çdo të keqeje e çdo rreziku.

Tani edhe dy fjalë: më erdhi mirë që i paske shkruar Cenos. Ah, Telo, sikur të vinte edhe ai gjatë këtyre ditëve! Sidoqoftë unë tani kam shumë besim dhe jam më e qetë.

Të lutem më shkruaj sa më gjatë e për gjithshka që po bëni gjatë kësaj periudhe të zjarritë e të vështirë.
21 mars

Vita»

«Dje patëm edhe një mbledhje ku merrte pjesë edhe një i deleguar nga rrethi. Ajo u bë për shkak të disa parullave që janë përhapur nga njerëz të dy-

shimtë. Në këtë grackë kishte rënë edhe korrieri i Jshatit, Selimi. Ti e njeh, ai është njeri i leshtë e i drejtë, sa s'i kupton gjëkundi hiletë. Kështu, kur ne e ftuam të bashkohej me shokët, ai na u përgjigj:

— Përse? Unë nuk kam njollë. Hekuran Rexha hyn, se është i lyer gjer në grykë.

— Po pse është i lyer ky plak i ndershëm? — i thamë.

Atëherë ai ngriti supet e s'diti si të na i shpjegonte. Me sa duket të shkretit ashtu do t'ia kenë thënë dhe ashtu e tha. Në mbledhje, i deleguari e preku shkarazi edhe këtë fjalë të tij të padrejtë.

— S'ke bërë mirë, — i foli me keqardhje. — Ti je njeri i Partisë, kurse këto janë parulla të nxjerra nga një thes i huaj.

— Mos deshët të thoshit nga i armikut? — provokoi me dinakëri Gjatovili për t'i dalë i deleguari në shtegun që i duhej.

— Sigurisht — tha pa të keq ai.

Mirëpo kaq u desh. Njëzet vetë u ngritën njëherësh. Veç të dëgjoje se si buçiste dhoma nga britmat kërcënuese të tyre!

— Kë? Kë quan ti armik? Selimin? Selimin tonë partizan?

Në krye të tyre shquante Ethem Koburja me një kosore në dorë, kurse Bajram Gjatovili, pa gjë në duar, po që në të vërtetë ishte ai që e kishte bërë të merrte flakë këtë zjarr të mbuluar. Moment i vështirë. Tani gjendja me të vërtetë kishte marrë dallgë. Njerëzit vështronin kundrejt nesh. Disa me habi e të tjerët me zemërim. Që të gjithë të tronditur në fytyrë. Po i deleguari në heshtje akoma vështronte e i dëgjonte i qetë. U çudita duke e parë ashtu. Pastaj ai e la presidiumin dhe duke u ngritur bëri përpara

drejt njerëzve që thërrisinin, ku midis hunjve e shatave shquante kosorja e Ethem Kobures. U shqetësova nga ajo skenë, po ai i shkoi pranë korrierit te banka ku qe ulur.

— Selim! — i tha — Më fal, shok, nëse padashur të fyeva sado pak. Ne kemi qenë bashkë në një çetë, në një batalion. Bile, bashkë dikur...

Selimi i prekur e gjithë i hutuar nga ajo që po ndodhte kish ngrirë në vend.

— Shoku Gjergj — mërmëroi — po mua... ju mua...

Desh të vazhdonte, po zërat e atyre që qenë ngritur, nuk e lanë.

— Duam nderin! Duam nderin! Këtu u fye Selimi e ne të gjithë...

Atëherë Vitë, më hipi gjaku në kokë.

— Ai nuk fyeu as atë e as ndonjë nga ne këtu! — thirra me zemërim — Ç'nder kërkoni të ju vihet në vend?

Pas atyre fjalëve salla përsëri mori dallgë. Shata e hunj të prira nga kosorja e Ethem Kobures filluan të lëvrinin në erë e, bashkë me to, edhe britmat:

— E shikoni? Nderi i Selimit nuk po vihet në vend! Atë gjeti ekipi për ta cilësuar armik?! — dhe në atë valë për t'i hedhur në përleshje njerëzit e mashtruar, Ethem Koburja, duke dalë nga banka ku kish zënë vend, bëri drejt presidiumit. Pas tij edhe njëzet e dy të tjerë. Shumica nga fisi i Gjatovilëve e i Koburëve. Qe ngritur edhe Bajrami, po ai u qëndronte disi larg.

Çast i vështirë. Tani vërtet mund të ndodhte përleshja. Njerëzit e revoltuar ishin në vërshim.

Duke parë këtë gjendje, dhe duke e njohur Ethemimin si kriminel e vrasës të dy të tjerëve, Hekuran

Rexha që shenjat e dhëmbëve të Kobures i ka akoma në krah, pa rënë në sy e afroi revolverin që e kish thellë në brez. Më ra në sy ai veprim i tij dhe e pa-shë me kërcënim. Ai e kuptoi gabimin që ish duke bërë dhe e tërhoqi dorën që andej. Po me gjithë qortimin që i bëra atij, zemërimin nuk e përmbajta dot ndaj atyre që po provokonin aq hapur. Kështu, duke u ngritur thirra:

— I deleguari s'pati asnjë gabim! Asnjë gabim!

Por ai më pa duke zgurdulluar sytë e më briti, sa unë mbeta i hutuar nga ai qortim:

— S'të pyeti njeri, shoku Telo! Ulu, të lutem! Ulu, po të them! S'qe ti, po unë, ai që po thonë se gabo... Dhe prapë jam unë ai që po kërkon ndjesë. Zërit të masës gjithnjë i kam besuar më shumë se sa zërit të një njeriu të vetëm.

Dhe ashtu, i vetëm, hyri midis atij lumi të turbullt që po derdhej me zemërim.

— Shokë! — tha. — Në keni hak për të marrë, ja ku më keni. Por unë, ama, atë që po kërkon, besoj se e bëra që në fillim! — dhe prapë, duke u kthyer nga korrieri:

— Selim! — i tha, — edhe një herë, shok, falëm, në të fyeva pa dashur!

Atij i qe kuçur goja. Prapë s'foli, veçse kësaj here i përlotur shtriu krahët dhe e pushtoi të deleguarin.

Tani britmat kishin pushuar, po gjakrat akoma ishin të ndezura. Kaq, Vitë. Pastaj i deleguari u kthye e zuri vend duke më bërë shenjë të heshtja. Po në këto çaste një e papritur ndodhi me plakun Ramë Sula. Pa folur, ai u çua dhe erdhi e u ndal para nesh:

— Bir! — i tha të deleguarit — ti s'bëre asnjë faj.

Koha do t'i zbulojë fajtorët. Unë jam i bindur për këtë. Sidoqoftë, megjithëse hëpërhe s'kisha vendosur të hyja në këtë bashkim, tani, ju lutem, shënojeni edhe emrin tim dhe lejomëni mua plakun të largohem që këtej! — dhe para se të dilte, duke e përqafuar, sërish i tha: — Me një urtësi të tillë çështja do të fitohet medoemos, more bir! S'ka gjë që ka thënë Partia dhe s'është bërë! — Dhe doli.

Pastaj fjalën e mori prapë i deleguari. Për t'i vënë kapak asaj mbledhjeje foli shkurt për situatën në përgjithësi. Në mbyllje:

— Shokë, — tha, — ne këtu s'jemi mbledhur për ngritjen e kooperativës. Atë, a e ngrini a s'e ngrini, e dini ju. Pra, është puna juaj, e mbështetur në dëshirën dhe në vullnetin tuaj dhe vetëm në dëshirën e në vullnetin tuaj.

Atëherë Bajram Gjatovili, Ethem Koburja e ndonjë tjetër mbas tyre, duke u shkëndijuar sytë nga gëzimi e, duke e quajtur davanë të fituar, filluan të thërrisnin:

— Rroftë drejtësia! Rroftë drejtësia! Ja, ne këtë duam! Këtë duam! Të mos ngrihet kooperativa, shoku i deleguar. Të mos ngrihet kooperativa!

— Jo, — tha i deleguari. — Jua thashë: Ajo kurrë s'do të ngrihet pa vullnetin e dëshirën e popullit të këtij katundi.

Kështu, Vitë. Pastaj mbledhja u mbyll e njerëzit filluan të delnin nga salla. Ethem Koburet e Bajram Gjatovilët fluturonin nga gëzimi.

— Telo, — më tha i deleguari, — komunistët të mbeten! — Pastaj një mbledhje tjetër vazhdoi për ne. Prapë foli ai. Po kësaj here shumë shkurt.

— Shokë! — na tha. — Që prej këtij çasti pikat e rendit të ditës ndërrojnë vend. Në krye s'qëndron më

lufta për bashkimin e tokave, po zbulimi i këtij kurthi të armikut. Pa zbulimin e tij s'ka ngritje të kooperativës në këtë fshat. Kurse dita e zbulimit ma merr mendja se ka për të qenë edhe dita e triumfit të kësaj çështjeje për të cilën ju po luftoni kaq gjatë.

Tani, Vitë, mëso se për ne ka gjumë pak ose aspak. Pa u rënë në sy, duke u aktivizuar të gjithë, e sidomos duke aktivizuar edhe disa nga anëtarët e bashkimit të rinisë, po e ndjekim veprimtarinë e tyre armiqësore hap për hap. Jo vetëm ditën, po edhe gjatë netëve lidhur me takimet që bëjnë.

Kaq për sot.

21 mars

Yti
Telo»

Të nesërmen, kur Lume Bani shkoi të takonte të sëmurën, papritmas, me të hyrë në dhomë, ajo briti nga gëzimi:

— Ceno! Ceno! Paske ardhur?!

— Erdha mbrëmë! — tha ushtaraku dhe duke u ngritur u përqaftua me të, ashtu siç qe përqaftuar një natë më parë me të motrën.

*

*

*

As edhe ditët që kaluan nuk e ndryshuan gjendjen. Numri i njerëzve të shkruar në atë listë kishte mbetur pothuaj ai i fillimit: gjashtë të parët e Ram Sula që qe shtuar në fund, shtatë. Nga shumica që mbetej, një pjesë e mirë, të hutuar nga pëshpëritjet,

qëndronin në mëdyshje, duke menduar «Pa të shohim një herë ç'do të bëjnë kjo ose ajo palë!», kurse pjesa tjetër në lagjen e Dokajve, fis e akraballëk i Gjatovilëve dhe Koburëve, qenë lidhur me Ethemin e Bajramin, të cilët u kishin folur e biseduar si kishin mundur e kishin ditur, ashtu siç kishin biseduar ditë më parë edhe me Share Gremin. Dhe vërtet kjo lidhje kishte bërë punën e vet të ndijshme.

Veçse, në këtë front besëlidhjeje, Share Gremi s'para e kishte dhe aq mirë fillin e punëve të tij. Ditën kërciste në pyll, që të mos takohej me komunistët dhe miqtë e vet të fshatit, e natën gjente belanë me të birin.

— Baba, unë nuk mund të ndahem nga shokët. Unë jam anëtar partie dhe vëlla dëshmori. Për këtë punë të kam shkruar dhe për këtë erdha edhe këtu. E mban mend? Edhe ti më shkruaie se s'kishe për t'u ndarë nga shokët e nga Partia. Po tani, pse kështu?

Po ai duronte sa duronte e pastaj, i ndezur, ia priste shkurt e me të nxehur.

Megjithatë i biri as tundej e as tërhiqej. Vec ndonjëherë prej dëshpërimit i mbusheshin sytë me lot e heshtte për ndonjë çast. Atëherë Dilja e lënduar kthehej e i zbrazej të shoqit:

— Përse, or burrë, ia thyen zemrën e ia ul kryet djalit?

— Ç'më çan kokën, moj! Atë e di unë. Me gjallien time s'ka kooperativë për shtëpinë e Grëmeve — dhe nërsëri klithte, duke i shfryrë sa asaj aq edhe të birit. Kështu nisi, gjersa një mbrëmje ai ngriti dhe dorën mbi të shoqen. Djali, i zbetë, u hodh në mbrojtje të së ëmës, duke ia prerë:

— Mos e prek nënën! Ajo s'të ka faj, — dhe, duke iu kthyer së ëmës, shtoi prerazi — Zgjidh e merr,

nënë! Këtu ka vetëm dy udhë... Unë do të shkoj andej nga është e drejta. Ti mendo e bëj si të duash! — dhe, pa e vështruar më të atin, ktheu krahët e u largua nga dhoma.

Plaku ndjeu një goditje të fortë në zemër.

Ajo që kishte ndodhur ende i dukej e pabesueshme, i dukej si një ëndërr e tmerrshme që të zgjon me llahtar nga gjumi.

E në atë çast, përsëri i doli para syve Bajrami duke i rrëfyer historinë e së bijës me atë çunin e Temo Banit, që e kishte prerë në besë.

— Ja këtë, këtë kërkon yt bir, — i tha së shoqes.
— Ta nxjerrë të motrën në mëzat, t'ia kullandrisin bukuroshët. Por jo, jo, gjersa të ketë Share Grem në këtë shtëpi, kjo s'do të ngjasë kurrë! — dhe, duke e vështruar të shoqen me egërsi, klithi:

— E more vesh! Kurrë, kurrë!..

*

* *

Kishin kaluar plot gjashtë ditë që kur Cenoja kishte ardhur me leje në fshat. Atë mbrëmje ndaj perëndimit një makinë hyri në katundin Iliras. Ajo ndaloi përpara shkollës. Njerëzit që ndodheshin aty u ngritën e u grumbulluan rreth saj.

Njeriu që zbriti u dha dorën e i përqafoi me radhë vendësit.

— Mirë se ardhët, shoku sekretar! Mirë se ardhët!

— Mirë se ju gjeta! — tha ai e duke u ndalur i pyeti një për një për punët dhe shëndetin.

Pastaj, duke çarë midis asaj turme, e i shoqëruar

nga ai grumbull njerëzish, mori udhën në drejtim të qendrës së fshatit.

— Sonte do të jeni tek unë, — i tha Heke Rexha duke i hedhur krahun.

— Jo, — iu përgjig ai mirënjohës. — I kam premtuar Share Gremit.

— Shares?! — u ndjenë njëherësh zëra habie nga ata që i ndodheshin pranë.

Sekretari buzëqeshi. Pastaj i qetë shtoi:

— I kam marrë vesh të gjitha. Sharja këtë herë e ka humbur terezinë. Po me zemër jam i sigurt se është yni. Ai ka dhënë gjakun për këtë që po ndërtojme... Apo s'është kështu, shokë?

— Po, — tha dikush nga bashkëfolësit i zënë ngushtë.

— Të themi të drejtën kësaj here as ne s'dimë se ç'po ndodh me të..., — shtoi edhe ai që e kishte ftuar sekretarin në shtëpinë e vet.

— Unë kam besim se gjithçka do të sqarohet e do të rregullohet, — tha rishtazi ai i qetë dhe i qeshur.

— Edhe ne ashtu besojmë! — pohoi një tjetër e, duke u kthyer nga një i ri me uniformë ushtarake, vijoi:

— E njihni, shoku sekretar? Ky është Cenoja, djali i vetëm i Shares. Ka ardhur me leje nga ushtria.

— Oh, Ceno! — tha sekretari buzagaz dhe, duke i dhënë dorën, shtoi: — Paske ardhur pikërisht në këto ditë lufte e përpjekjeje për fshatin!

Tjetri u gatit e në qëndrim ushtarak i shtrëngoi dorën. Pastaj të gjithë së bashku vijuan udhën gjër të korija e Sotajve.

— E, — tha djaloshti — kështu siç jemi bujrim! —

dhe duke iu kthyer sekretarit shtoi: — Erdhëm, shoku Stavri. Ja, kjo është shtëpia jonë.

— E di, e di, — ia ktheu tjetri, duke i hedhur krahun.

Pas pak të tjerët u ndanë, e ata të dy hynë në shtëpi.

*

* *

Konaku i pritjes në shtëpinë e Share Gremit ishte i thjeshtë. Asgjë nuk të zinte syri përveç dy rrogzave të shtruar në të dyja qoshet, që mbuloheshin pjesërisht nga dy velenxe leshi. Në vatër një kandil i gjatë prej teneqeje e që lëshonte një dritë të zbehtë, nga fundi i konakut dy shtëmba uji dhe një legen e një ibrik pranë, nga ata të kohës së zëzimit. Ja, kjo ishte e tërë pasuria e kësaj dhome pritjeje. Po pasuria e vërtetë e kësaj shtëpie ishte mikpritja e njerëzve të saj. Tani muhabeti porsa kishte filluar. Në njërin qoshe kishte zënë vend sekretari e në tjetrën nënë Dilja me të birin.

I zoti i shtëpisë, si për çudi të sekretarit, ende nuk po dukej në konak.

— Ç'u bë Sharja? — pyeti mysafiri, duke iu drejtuar gruas.

— Puna e tij është një histori e tërë! — tha djali i hidhëruar.

— Pse? — pyeti rishtas mysafiri.

— Po bëhen ditë, shoku sekretar, që im atë s'është më ai i pari. Natën s'fle në rregull e ditën, pa u gdhirë mirë, del nga shtëpia e shkon në pyll. Atje qëndron

gjithë ditën për t'u shpëtuar takimeve me shokët e miqtë e tij të fshatit. Vonë, si erret mirë, kthehet hundë e buzë e po t'i zësh ngoje kooperativën atëherë fryn e shfryn si i marrë.

Me të mbaruar fjalën, djali u ndal e psherëtiu.

— Po, po — pohoi pas pak djaloshi. — Diçka ndodh tek ai, po unë ende s'kam mundur t'ia gjej rrënjët atij farmaku që i ka helmuar gjakun.

— Ai është njeri i drejtë, — tha gruaja, duke ia marrë fjalën nga goja të birit. — Kur u martuam, i yshtur nga fjalët e botës, dy vjet me radhë u soll shumë keq me mua. Mbushej jashtë e pastaj vinte e zbrazej në shtëpi. Unë e di se ç'kam hequr ato dy vitet e para. Po që atëherë kanë shkuar më se 26 vjet e unë s'di të më ketë goditur herë tjetër, bile as të më ketë kërcënuar, veç asaj së mbrëmshmes. «Shtjer, — i thashë, — veçse djalit mos ia thyej zemrën e mos ia ul kryet para shokëve» Po ai s'më ktheu përgjigje. Si mbetëm vetëm, mori e piu e pastaj qau si fëmijë. «Pse qan» e pyeta. «Ti dhe yt bir s'dini asgjë! — më tha i dëshpëruar. — Po unë i kam marrë vesh të gjitha. Edhe qëllimin pse Telo Bani me të tjerët përpiqen për të ngritur kooperativën» dhe me hollësi gruaja përshkroi të dy takimet që kishte pasur Sharja me Bajram Gjatovilin dhe gjithë ato fjalë që i kishte thënë ai.

— I poshtri! — shfryu ushtaraku. — Duke përfutur nga padjallëzia e tim eti akoma kërkon të na tërheqë për hunde. Dhe sa për Telon, — shtoi i qetë, — ai i ka shokët të rrallë në fshatin tonë. Është e vërtetë që ai e do Vitën dhe Vita atë. Ata kërkojnë të fejojnë. Për këtë më kanë folur edhe mua, para se të shkoja në ushtri. Dhe unë qysh atëherë i fola nënës

për punën e tyre. Dhe prapë them: ata e meritojnë
mjeri-tjetrin dhe ne s'kenim asnjë të drejtë që t'i pen-
gojme.

— Të lumtë, — tha sekretari, duke e vështruar
me përzemersi ushtarakun. Ti gjykon tamam siç u
ka një komunisteve. Veçse kjo që mësova me pikëllon
rënde.

Pastaj, pas një heshtjeje të thellë:

— Po Vita, ku është? — tha.

Cenoja u çua për ta thirrur.

Mbas pak një vajzë e hijshme, me shtat të gjatë
e të mbushur, hyri në dhomë.

— Mirë se ardhke, shoku Stavri! — dhe i dha
dorën.

— Ulu, ulu! — i tha sekretari.

Vajza u ul e zuri vend pranë tij.

— Po si je me shëndet, moj Vitë? — dhe duke e
shikuar drejt i erdhi keq kur e pa ashtu të prerë e të
zbetë në fytyrë.

— Jam mirë, shoku Stavri, — tha ajo me zë të ëm-
bël e të qetë.

— Mirë, ë? Ashtu do të dëshëroja...

Ajo uli kryet. Ndeu vështrimin përdhe e s'ktheu
përgjigje.

— Më vështro, më vështro drejt!

Vajza buzëqeshi, duke hedhur vështrimin drejt
tij.

— Ja kështu, — shtoi rishtazi i ardhuri. — Popu-
lli thotë se miku të vështron në sy, kurse armiku nga
këmbët.

Ajo prapë qeshi e, me të, edhe nëna me Cenon.

— Keni të drejtë, — shtoi ushtaraku duke e shfa-
qur hapët gëzimin që ndiente.

Tani edhe gruaja, e çelur në fytyrë, vështronte buzëgaz mysafirin.

— Ne gëzohemi, bir, kur na vjen në shtëpi — i tha.

— U bënë katër muaj që s'jeni dukur këndeje, — shtoi vajza, megjithatë s'na paskeni harruar, — dhe prapë vuri buzën në gaz duke nxjerrë jashtë ata dhëmbë të bardhë e të rënditur si ndonjë varg rruazash fildishi.

Sekretari e kundroi një çast:

— Po për ngritjen e kooperativës, a po ndihmoni nga pak ju të rinisë?

Ajo u skuq e si nëpër dhëmbë tha:

— Sipas mundësisë, shoku Stavri.

Sekretari tundi kryet e i ra krahëve.

— Mos u mërzit! Të gjitha do të zgjidhen. Bashkimi i tokave do t'i plotësojë rinisë edhe ëndrrat më të bukura e më të guximshme. Ai do ta zgjidhë edhe hallin tënd, Vitë!

Nëna u përlot nga gëzimi, kurse vajza e skuqur ndjeu një goditje në zemër, po një goditje që kishte diçka të ëmbël në vetvete.

«Mos vallë e ka mësuar historinë?» mendoi në heshtje dhe në çast Teloja i doli para syve. Iu duk sikur ia kishte vënë të dyja duart mbi supe e prapë po i përsëriste ato fjalë që ia kishte thënë disa herë:

«Mos u shqetëso! Ne askush s'do të mundet të na ndajë! Ne kemi të drejtën.. Ne kemi Partinë me vete».

Po fjalët e sekretarit e larguan nga ky ëndërrim i bukur.

— Pa më thuaj, njëherë, a mblidhet në rregull organizata juaj e rinisë?

— Po, — tha vajza.

— Çudi! — foli ai si i menduar.

— Përse çudi? — tha ajo.

— Se unë kam dëgjuar ndryshe, — dhe i shkeli syrin Cenos. — Më kanë thënë se ju s'mblidheni fare, dhe kjo jo për fajin tuaj, po për faj të sekretarit të organizatës së Partisë, që s'interesohet për punët e rinisë! — Dhe si heshti një çast, duke e vështruar ëmbël me bisht të syrit, pyeti: — Po a s'më thua, cili është sekretari i organizatës së Partisë në këtë fshat?

Ajo uli kryet dhe duke u skuqur edhe më shumë shqiptoi nëpër dhëmbë emrin e Telo Banit.

Sekretari buzëqeshi, duke e vështruar ëmbël ushtarakun, që edhe ai tani e kish buzën në gaz.

Vajza e skuqur nga turpi u hodhi një sy tërthorazi të treve e pastaj me gjysmë zëri pëshpëriti:

— Juve gjithmonë ju pëlqejnë shakatë, shoku Stavri.

Po ajo s'mundi të vazhdonte më tej. Në mbarim të atyre fjalëve u ndie ajo e «kollitura» e zakonshme e pastaj zëri i vrazhdë e i fortë i të atit.

— Grua! Grua, moj! — thirri dhe, pa pritur përgjigjen e së shoqes, çeli derën e u dha te pragu i atij konaku të vogël, ku papritur e pakujtuar vështrimi i tij u ndesh me atë të mysafirit.

— E po, ku je, or xha Share? — tha i ardhuri buzagaz dhe menjëherë u çua në këmbë për ta nderuar.

Tjetri, i zënë ngushtë, ndjeu një farë dridhjeje në zemër e pa e kuptuar dhe ai vetë shtangu për një çast te pragu. Po tani ishte vonë. Udhë e tërheqjes i që mbyllur.

Me turp u afrua e i dha dorën, po jo ashtu me zemër e gjallëri si herët e tjera. Në atë çast vajza, duke i hedhur një vështrim nënës, u ngrit e doli jashtë. Pas pak u ngrit edhe gruaja.

Kishte kaluar një copë kohë, po Share Gremi akoma qëndronte si mbi gjemba.

«Eh, e mori djalli! U ruajta nga shiu dhe rashë në breshër!» ankohej me vete pa e shikuar drejt mysafirin e pa ia hequr sytë varricës së druve e asaj flake që ngrihej përpjetë në atë vatër pa oxhak.

Po mysafiri i qetë, duke e nisur muhabetin larg, e larg, filloi të tregonte për ngjarjet e ditëve të fundit nëpër botë e pastaj edhe për ato që kishin ndodhur e po ndodhnin në vendin tonë.

«Të shohim ku do t'i dalë krisma!» tha Share Gremi me vete, pa i kthyer përgjigje mikut e pa guxuar ta shihte drejt në sy.

Po mysafiri i qetë tregoi sa tregoi e pastaj e hodhi fjalën te disa kujtime të bukura të kohës së Luftës. Me ato ngjarje lidhej edhe jeta e atij plakut të Gremëve e sidomos ajo e djalit që i qe vvarë.

— Eh! — psherëtiu plaku padashur, — Çfarë ditësh e kohësh kemi kaluar! — dhe duke harruar të tashmen humbi për disa çaste në ato kujtimet e largëta të atyre viteve të shkuara.

Iu duk sikur para syve të tij u përtërinë edhe një herë ato ditë lufte, me ato ngjarje e ata njerëz. Ja edhe i biri, Hysniu, i vogël e i rëgjuar, po shpuzë e i shpejtë si vetëtima, duke iu lutur të mos e pengonte për të shkuar maleve me partizanët.

Dhe Share Gremi s'donte ta largonte atë fytyrë të dashur nga ata sytë e vrenjtur e gjysmë të mbyllur. Për disa çaste ai i qëndroi i gjallë përpara syve, ashtu si dhjetë vjet më parë, kur, ndryshe nga të tjerët, hynte e dilte me bujë nëpër shtëpi. E në ato

përfytyrime erdh e i mbet ndër sy edhe ai çasti i nisjes. Shkuan në një ditë, bashkë me atë djalin e Temo Banit. Po fytyra e këtij të fundit befas diç i solli në kujtesë. Pastaj një rrëqethje i përshkoi trupin plakut dhe filli i kujtimeve iu pre në mes.

— Eh! — psherëtiu, duke mbledhur veten dhe i erdhi keq që fytyra e këtij të fundit ia largoi të birin nga sytë.

Po mysafiri përsëri e vijoi bisedën për luftën. Kur ishte në të mbaruar, dera u çel dhe nënë Dilja hyri me një sini në duar. Djali u ngrit ta ndihmonte.

— Pse u vonuat kaq, moj grua? — tha plaku si për t'u gjendur në muhabet.

Pas pak sofrë u shtrua dhe i zoti i shtëpisë, duke i uruar mirëseardhjen mysafirit, e ftoi të ngrinte gotën.

— Ta pimë për kujtimin e Hysniut e të shokëve të tij që ranë për lirinë dhe për të ardhmen tonë! — tha sekretari me fjalë të dala nga zemra.

— Të lumtë ajo gojë dhe më rrofsh sa malet, or bir! — shtoi plaku, që me mend ishte akoma te historia prekëse që i rrëfeu mysafiri për rënien e të birit, megjithëse nuk ishte e panjohur për të.

Pastaj të dy njëherësh i kthyen me fund gotat e mbushura gjer në grykë.

Pas buke prapë vijuan muhabetin. Po tani për diçka tjetër. Shtëgun e hapi mysafiri:

— A s'më thua, xha Share, ç'ka vendosur fshati juaj për të ardhmen e tij?

— Për ç'të ardhme? — u shti plaku.

— Për atë që dhanë jetën shokët tanë. Për atë që ra Hysniu.

Plaku u vrenjt e heshti për një çast.

— E kam fjalën te ngritja e kooperativës, — thek-

soi rishtazi sekretari, kur vuri re ngurrimin e tjetrit.
Po i zoti i shtëpisë psherëtiu e prapë s'ktheu përgjigje.

Mysafiri e pa dhe pa ia hequr sytë qëndroi një copë herë në pritje.

— Më mirë të mos e hapim këtë plagë, — tha më në fund plaku me zë të shuar.

— Plagë?! — pyeti si i çuditur mysafiri.

— Se ashtu janë punët në fshatin tonë, — u qa tjetri pa u shtyrë më tutje.

— Nuk besoj t'i keni punët ndryshe nga të tjerët! — tha sekretari i menduar.

— Unë jam plak, or bir. Në më njeh, besoji fjalës sime. Këtu njerëzit që drejtojnë punët s'e kanë hallin të bashkimi i tokave, po të çupat, për t'i kullandrisur sipas qejfit të tyre.

— Gabohi! — shtoi sekretari, po këtë herë i shqetësuar.

— Po unë këto që po t'i them i kam të sigurta! — tha me një lloj nervozizmi plaku.

— Të sigurta?! — ndërhyri i biri. — E nga kush i ke këto fjalë të sigurta, baba?

— Ti hesht! — ia preu ai tashmë i nxehur. — E di unë se nga kush i kam. E gjersa puna është kështu, për së gjalli s'hyj në kularin e tyre. Kur të vdes unë, ti bëj ç'të duash...

— Po të jetë kështu, edhe unë jam me ty, — shtoi mysafiri. — Po ju e dini ç'është Partia dhe ç'bën ajo kur nderi i njerëzve merret nëpër këmbë.

— Te nderi ta kam fjalën, or bir. Po te ne nderi ka vdekur qëkur...

— Baba! — tha djali sërishmi. — Është më mirë të tregosh njerëzit që të kanë yshtur, se sa të flasësh kështu për të tjerët...

— Ti hesht! — përgjegji me të sertë plaku.

— Jo, — tha djali. — Tani s'është koha për të heshtur, po për të nxjerrë në shesh ata që s'na e kanë me të drejtë.

— Atëherë mos lllomotit, po fol, për kë të ha zemra keq?

— Për Gjatovilët, baba, për Gjatovilët, e sidomos për atë Bajram qenin, — theksoi djali duke e vështruar të atin në sy.

— Për atë edhe ne kemi të dhëna të këqija! — shtoi sekretari. — Gjatë këtyre ditëve të fundit lloj-lloj shpifjesh e kurthesh ka ngritur nëpër fshat.

— Ai ka folur keq edhe për tēt bijë... E bile jo vetëm për tēt bijë — shtoi ushtaraku.

— Nga e di ti? Dhe çfarë ka folur? — tha plaku me hutim.

— Gjithçka ka mundur e gjithçka i ka ardhur ndoresh, duke i dhjetëfishuar ato që të tha ty. Po gjersa ka gjetur shesh, pse të mos e bëjë përshesh nderin e familjes së Share Gremit? Pse të mos e bëjë leckë motrën e Hysni Gremit e të Ceno Gremit për të arritur qëllimet e tij kundër këtij bashkimi?

Plaku u drodh. Fjalët e fundit i ranë si thikë në zemrën e pikëlluar, ndërsa fytyrën e vrenjtur ia mbuloi një hije edhe më e errët.

Po djali prapë vijoi:

— Fol, baba, kush ta ngriti tēt bir nga fusha e luftës? Kush ta mori të gjakosur mbi krahë? Telo Bani, apo Bajram Gjatovilët me Ethem Koburët? Kurse ti sot, duke marrë mendtë e Gjatovilëve, je tërbuar kundër tij. Përse? Përse, kur ai s'ka asgjë të keqe kundër nesh, kur ai s'di asgjë për ato që po thuren kundër tij dhe sat bije?

— Follmë po të them! Kush t'i tha të gjitha këto? Kush? Foll!

— Fshati. I gjithë fshati. Ne po bëhemi lodra dhe gazi i botës. E nga kush pa? Nga ata që gjer dje na kanë rjepur lëkurën.

Share Gremi i vrarë nduku buzët. Pastaj:

— Sii? — tha. — Ti nuk beson se Telo Bani ka shkelur në nderin e sat motre? Në nderin e shtëpisë sonë?

— Jo! Dhe kam të drejtë më shumë se çdo tjetër të mos e besoj.

— Ti? Ti paske të drejtë më shumë se ne të tjerët? Ti që ke qenë larg e s'di se ç'kurthe po ngre Telo Bani me shokët e vet në fshat?

— I di, baba. I di të gjitha. Po jo ashtu si i di ti. E as ashtu si t'i tha Bajram Gjatovili për të të mashtruar. E vërteta qëndron ndryshe, krejt ndryshe. E këtu edhe yt bir ka përgjegjësi të rëndë që u dha rast ta hidhnin gurin mbi çatinë e Share Gremi.

— S'po të kuptoj, more bir! Më hutove! — ia bëri tjetri ndanë vatrës i pezmatuar. — Po ç'përgjegjësi ke ti në këtë punë të ndotur?

— Që heshta, baba. Që s'guxova të ta thosha para nisjes për në ushtri se Telo Bani ndershmërisht kërkonte të fejohej me Vitën. Unë me zemër qeshë dakord me atë kërkesë që në atë çast, po kjo punë më parë duhej biseduar me ty, se njeriu që do ta jepte atë pëlqim ishte ti. Po unë u nisa, pa guxuar të ta thoshja këtë çështje me rëndësi për shtëpinë tonë. Megjithatë në çastet e nisjes nënës ia thashë dhe e luta që ta bisedonte. Po me sa duket as ajo nuk guxoi. Në ikje këtë kërkesë të Telos ia thashë edhe sime motre. Ajo, kryeulur, m'u përgjigj: «Unë e çmoj atë, por dua të kem pëlqimin e babait e tuajin si familje».

Ja, kjo qe rruga qe ndoqën. Dhe unë pyes: Ç'gjë të turpshme kanë bërë këta dy të rinj? Ç'ka bërë Vita jonë, qe ne ta mbajmë ballin ulur?

— Asgjë! Absolutisht asgjë! — tha sekretari i vendosur, duke ndier një urrejtje të thellë për Gjatovilët e Koburët.

Share Gremit i erdhi konaku përqark.

— Bir, — tha pastaj me tronditje e hutim, — po atëherë këto fjalë për tèt motër e Telo Banin kush t'i ketë përhapur në fshat?

— Ata qe ta kanë nevojën, qe u duheshe si mashë, baba. Ata qe kërkojnë t'i vënë minat këtij bashkimi. Gjatovilët e Koburët. Me moshyrjen tënde në kooperativë ata shpresojnë t'i vënë fre në këtë fshat ngritjes së saj. Ja, kjo është gjithë e vërteta.

— Ashtu është... S'e lot gjë, — tha edhe sekretari, pa ia ndarë sytë fytyrës së vrarë e të pikëlluar të plakut.

— Domethënë, sipas teje, ai paska luajtur me nderin tim?

— Jo sipas meje baba, po ka luajtur... Dhe ka luajtur si ka dashur... Veçse le ta dijë Bajram Gjatovili, sa nuk është vonë, se nuk i ka bërë mirë llogaritë e veta! — dhe i nxehur ushtaraku ngriti grushtin dhe e tundi me zemërim. — Ja, baba, ja, për këtë nder tëndin e të sime motre kam ardhur. Po edhe për këtë bashkim...

— I poshtri! — tha plaku. — Në qoftë ashtu, do të di unë se çfarë përgjigje kam për t'i dhënë.

— S'ka, baba, s'ka përgjigje më të fortë se sa ajo e bashkimit me shokët! — tha djali duke e shikuar drejt të atin.

— Ashtu është, — pohoi i prerë sekretari. — S'ka përgjigje qe mund të zërë vendin e saj në këto çaste, xha Share.

Po Share Gremi s'hapi gojë. Një valë e trubullt mendimesh e rrëmbeu në krahët e veta.

— Baba! — tha rishtazi djali duke ndërhyrë. — Jepja fjalën shokut Stavri. Çdo zgjatje është vetëm për turpin dhe dëmin tonë.

Plaku u drodh nga ato fjalë. Në fytyrën e tij tani dukej hapët një shqetësim i ri.

— E? — këmbënguli djali pa e lënë ta bluante atë mendim.

Share Gremi e vështroi rëndë ushtarakun. Pastaj, me gjysmë zëri:

— Se të kemi tonin, more bir... — i tha sekretarit. — Gjyko e fol, po formë hapët, ama: a është kjo toka jonë, tokë për ta bërë kooperativë? A ka hair nga shëllira, or shoku Stavri? Apo sa të hyjmë në valle e pastaj të vijmë vërdallë, si kali në lëmë?

— Ashtu është! — u përgjigj sekretari i qetë. — Të gjitha duhet t'i shoshitim. Bile t'i shoshitim mirë e pa u nxituar. Njeriu edhe një dhi kur e ble në pazar matet e stërmatet dhjetë herë, duke e shikuar nga brirët, nga këmbët e nga dhëmbët e në fund, pas aq e kaq mendimesh, vendos ta blejë ose jo, — dhe i qetë mysafiri vështroi ëmbël të zotin e shtëpisë.

Plakut i erdhën për osh ato fjalë. Po tjetri vazhdoi:

— Kështu, që e patëm llafin, xha Share, ju u qatë për tokën. Dhe me të drejtë, sepse pjesërisht toka juaj është e kripur. Mirëpo a na e ndërron njeri? A mund të na zbresë ndonjë tjetër copëz tokë nga qielli?

— Jo! — tha plaku si për t'i bërë qefin mysafirit. — Ajo është punë që s'bëhet.

— Domethënë, ju mendoni se ashtu s'mund të na qahet halli.

— Po, unë ashtu mendoj.

— Mirë, po sikur të veprojmë ndryshe. Ja, sikur t'i hedhim sa më shumë pleh kafshësh ose pleh kimik, sikur në vend të punimeve të cekëta të parmen-dës t'i bëjmë punime të thella me traktor, sikur në vend të kujdesit të paktë, t'i rrimë më shumë në kokë, duke i bërë sa më shumë shërbime dhe këto brenda kohës së duhur? Për shëmbull. në vend të një prashitjeje, t'i bëjmë dy, tri, katër! E sikur t'i sjellim nesër edhe kanalin vaditës te koka? Më thoni, tani, po t'i bëhen të gjitha këto që thashë, kjo tokë, do të japë më pak apo më shumë nga ç'ka dhënë gjer më tani?

Plaku, i zënë ngushtë, nuk u përgjigj. Ai ngriti vetëm supet, e sytë e tij u hódhën mbi flakën e zjarrit, që ishte gati më të shuar.

Mysafiri e vështroi po nuk e nguti. Ai priti gjersa i zoti i shtëpisë u detyrua ta thyente atë heshtje.

— Eh! ia bëri ai i dëshpëruar. — Peshku në det e tigani në zjarr! Ja kështu është edhe puna ime, more bir! Unë s'kam se ç'të të fsheh ty. Shih e shkruaj, po mendo e gjyko, ama! Vër dorën në zemër e pastaj thuajmë a jam unë për kooperativë? . . . Siç e di, dalngadalë po i zë të gjashtëdhjetat. Po aq është edhe ime shoqe . . . Ç'kam tjetër? Një çupë, që e pret dera e botës! Kurse djalin? Djalin e kam ushtar, larg shtëpisë . . . E tani, më thuaj, si djalë shtëpie që je, a jam unë, me një gjysmë krah pune, për të hyrë në këtë valle?

— Mirë. Po para se t'u përgjigjem, unë do t'ju pyes për diçka — tha mysafiri.

— Pyet, or bir!

— A e njihni Liko Dyrmen?

— Po, e njoh. Është nga Morina, bile e kam edhe mik.

— E dini sa njerëz ka në shtëpi?

— Jo. Po e di që ka mjaft carronj . . .

Mysafiri qeshi.

— E thatë mirë. Vërtet ka mjaft! Shtatë fëmijë dhe më i madhi i tyre akoma s'i ka mbushur të nëntë vjetët.

— S'ua di vjetët, po për të vegjël, të vegjël i ka!

— Ashtu është! — shtoi mysafiri. — Ka shtatë, e që të shtatë kokla. Kur u krijua kooperativa në fshatin e tyre, dhe ajo, siç e di, që e para në rreth, ai u tremb e u nda nga shokët. Dhanë e morën, po s'që e mundur të bindej.

— Nuk i ushqej dot, — u thoshte. — Jam krah i vetëm. — Dhe vërtet i vetëm ishte. Ashtu dha e mori një vit të tërë. Po të dytin, e pikërisht një ditë gushti, kur unë kisha shkuar mik në fshatin e tyre, ai erdhi e më takoi. E përqafova dhe e pyeta për fëmijët.

— I kam mirë! — më tha në sy të të tjerëve, po kur do të largohesha më hoqi mënjanë.

— Jo, — tha, — ti nuk do të shkosh sonte.

— Kam punë, — i thashë.

— E di, — m'u përgjigj. — Po mos harroni se dikur kemi luftuar bashkë! Unë sot kam nevojë për këshillën tënde, për ndihmën tënde.

«Kushedi se ç'hall do të ketë», thashë me vete dhe kërkova të më thoshte ç'kishte.

— S'është hall për t'u biseduar në udhë — m'u përgjigj dhe, duke u kthyer nga e majta, shtriu krahun e tha:

— Ja kasollja ime. Në s'të vjen rëndë, eja sonte.

S'mund t'ia prishja dhe të dy së bashku bëmë përpara.

Në mbrëmje, gjatë darkës, ai më foli hapët.

— Të thirra, se e kuptoj që kam gabuar. Kam gabuar aq rëndë, sa më vjen turp nga shokët dhe s'kam sy e faqe t'u dal përpara. I shoh në fushë e kudo bashkë dhe i kam zili. Ndërsa veten e urrej, e urrej me gjithë shpirt. Po megjithëkëtë s'di si ta ndreq gabimin që bëra.

— E lehtë, — i thashë — pse nuk i bën lutje asamblesë për të të pranuar?

— Po sikur mos të më pranojë?

— Përse mos të të pranojë?

— S'e di! — më tha. — Por ja, zemra gjithnjë më ha për keq.

— Sillmë një copë letër, — i fola, dhe të dy u vumë e pregatitëm lutjen.

Pas disa ditësh mora vesh se ai ishte pranuar. Kurse pas dy vjetësh kasolles së tij ia zuri vendin një shtëpi dykatëshe.

— E drejtë. E kam parë, — tha plaku.

— Tani të kthehemi te pyetja juaj. Ju nuk jeni më plak se Liko Dyrma. Ndryshimi qëndron vetëm këtu: ndërsa ai me një krah përballon jetën e nëntë vetëve, ju jeni tre. Sigurisht në këtë numër nuk futa Cenon. Ai ka akoma dhe një vit ushtri. Po kur të kthehet, ju prapë do të mbeteni tre, se Vita, helbete, në këtë moshë, siç e thatë dhe ju, mysafire është në shtëpinë e babait.

Djali qeshi, po plaku s'i ngriti sytë nga vatra. I shqetësuar, ai shikonte tani qartë e për herë të parë se sfrati i tij s'ishte ngritur mbi themele të forta për t'i qëndruar atij lumi. Megjithatë prapë s'e dha ve-

ten. Psherëtiu e, si i hodhi një sy Cenos e pastaj mysafirit, tha nëpër dhëmbë:

— Mirë, or bir, po a mund të punojmë ne pleqtë me normë?

— Edhe këtë shokët këtu do ta mendojnë! — tha sekretari pa u nxituar. — Kooperativa është si një qeveri e vogël. Atje ka lloj-lloj punësh e sektorësh. Punë për të rinj e për pleq, për të shëndoshë e për të gjymtuar.

Plaku vështroi një çast me habi mysafirin, pastaj iu duk sikur gjithçka po përmbysëj.

Dhe vërtet tërmeti kishte filluar. Ai tërmet tani po tundte edhe mbeturinat e fundit të lidhjeve me atë copë tokë që kishte ëndërruar e dëshiruar një jetë të tërë e që e kishte marrë në duar tetë vjet më parë.

Mendja i shkoi tek arat e gjelbra, të mbuluara me të lashta.

— Po grunjat? — tha më në fund pa mundur ta fshihte tronditjen e atij çasti, — grunjat që i kemi mbjellë që në vjeshtë, qysh do t'i ndajmë?

— Ju vetë do të vendosni, — tha sekretari, — ose i bashkoni, duke i çmuar ditët e punës, ose, për sivjet, secili le t'i korrë për vete ato që ka mbjellë.

— Unë s'dua t'i bashkoj me njeri! — tha plaku, duke i sjellë dhe një herë ndër sy arat e mbuluara me grurë.

— Mirë! — pohoi miku. — T'i korrni e ta hani me shëndet grurin e ri!

Po sytë e Share Gremit tani nuk shikonin më përtokë. Ata i qenë ngulur thellë mysafirit, thujse donin të zbulonin ndonjë të fshehtë prej tyre. Po sekretari, i dliret e i ëmbël si gjithnjë, prapë shtoi me përzemërsi:

— Kështu, xha Share, gruri është juaji...

Plaku psherëtiu thellë. Pastaj:

— Më falni, — tha — po unë fjalëve s'mund t'u zë besë. Ju nesër ikni, kurse këtu, pas këtij bashkimi, të tjera havadize mund të na dalin.

— Çfarë havadizesh? — tha tjetri duke e shikuar drejt në sy.

— Nuk e di, more bir. Po, meqë jeni i sigurt për sa më thatë a mund të më lëshoni një teskere, ta kem për sido që të ndodhë?

— Teskere? — Tjetri u habit.

— Dekoratë, desha të them, — shpejtoi për ta ndrequr fjalën e parë.

— Do të thotë deklaratë, — sqaroi i biri, i skuqur në fytyrë nga ky qëndrim i padrejtë i t'et.

— Sa keq! — tha sekretari. — Ju i zënkeni besë më shumë një cope karte se sa fjalës dhe udhës së drejtë të Partisë! Thomëni, xha Share, cila fjalë e saj nuk ju ka dalë? Kur ju ka premtuar e nuk jua ka mbajtur fjalën?

— Sa turp, baba! — ndërhyri djali i prekur thellë nga sjellja e të atit.

Share Gremi nuk u përgjigj. Veçse tani s'ishte më i qetë. Dhe ashtu i kërrusur nga turpi, tha me vete:

« E mori djalli, e mori! Edhe kjo më duhej për t'u turpëruar tamam!... »

Pastaj, i murrëtyer në fytyrë, mermëroi me gjysmë zëri:

— Më fal, or bir, në gabova. Ne pleqtë nganjëherë bëhemi si çiliminjtë!

Po djalit akoma s'i kishte shkuar të kuqtë nga fytyra.

— Baba! — tha me ton të prerë. — Më duket s'na

ka hije të sillemi në këtë mënyrë. «Një fshat që duket s'do kallauz», — Përgjigju! Përgjigju me zemër të hapët thirrjes së Partisë!

Plaku ngurroi e duke e vështruar disi shtrembër të birin tha prapë, duke iu drejtuar mysafirit:

— Edhe një pyetje kam, or shoku Stavri.

— Po ç'hyjnë akoma pyetjet? — u ankua djali me një zemërim të hapët.

— Ti prit! — tha plaku. — Hallet i heq unë! ... — e duke iu kthyer sekretarit:

— Po demat, or shoku Stavri, a hyjnë në kooperativë?

— Nganjëherë hyjnë, — tha mysafiri, — po nganjëherë ngulin këmbë e s'lënë as të zotërit e tyre që të hyjnë.

Share Gremi s'foli. Ai e ndjeu veten ngushtë dhe erdhi e i mbeti i gjallë ndër sy kuçali i tij.

Mysafiri priti një çast, pastaj pyeti:

— Si thoni, xha Share?

Në këtë çast djali përsëri ndërhyri:

— Baba! Jepja dorën shokut Stavri!

Plaku u drodh e ato fjalë e sollën menjëherë në vete.

Po tani krahu i mysafirit, qe shtrirë në drejtim të tij.

— Jo jo, bir, — tha prapë i menduar. — Është akoma shpejt për të dhënë dorën. Unë këtu jam. Në mos tani, në gusht s'kam për t'u ndarë nga shokët.

— S'është ashtu, — tha sekretari, pa e ulur dorën. — Në rëntë një e keqe Partia e di se Share Gremi apo Stavri Kondakçiu, Teloja apo Cenoja do ta hedhi në krah atë dyfek që e ruajnë për një ditë të vështirë e do t'i thonë: «Na thirre? Erdhëm... Ja ku na ke!» Po Partia do të na përgjigjet: «Unë e dija

që do të vinit, se ju jeni të mitë dhe unë juaja. Se as unë bëj dot pa ju, as ju pa mua! Por kaq është pak. Tepër pak. Populli thotë: Trimi i mirë me shokë shumë. Dhe unë, meqë juve ju kam në radhën e trimave të mirë, pres të më vini me shokë të shumë!» Më kupton, xha Share? Kjo është detyra e secilit nga ne në këto çaste të rëndësishme, ku vendoset e ardhmja e njerëzve tanë të fshatit.

— Ashtu është, shoku sekretar — tha djali. Dhe duke iu kthyer të atit: — Jepja dorën, baba! Jepja dorën shokut Stavri! Nderi yt është të na prijsh për të bashkuar edhe të tjerët. Shoku Stavri ta tha hapët se ç'pret Partia prej teje e prej ne të gjithëve.

Në ato çaste një ngjyrë e kuqe e ndezur mbuloi fytyrën e plakut. Pastaj sytë e tij herë vështruan nga mysafiri e herë nga djali, që vazhdonte ta nguste për t'i dhënë fund asaj mëdyshjeje.

— Bir! — tha së fundi me një ton sa lutës, aq edhe pyetës.

— Dorën, dorën baba!

Tani sekretari që ngritur më gjunjë e sa s'po përqafohej me plakun.

Kështu ngjau, pastaj, pa e kuptuar dhe ai vetë, shtriu krahun e u gjend papritur në krahët e mysafirrit.

— Të lumtë, xha Share! — tha miku. — Të lumtë!

— Të lumtë, baba! — briti edhe djali, e duke iu hedhur në qafë e puthi.

— Kjo për ty bëhet, or bir! — tha ai e dy lot shndritën në sytë e tij të zinj si jeta e atyre kohëve të shkuara. Pastaj, duke shikuar mysafirin, prapë shtoi — Unë sonte vetëm dorën të dhashë, ore shoku Stavri, po fjalën e fundit nesër e ke nga unë.

— Ajo mbaroi tani, baba, — tha djali dhe vra-
poi t'i jepte sihariqin së ëmës.

— Thirr edhe Vitën, — shtoi sekretari e, duke e
shikuar me dashuri plakun, prapë e pyeti:

— Po puna e Telos me Vitën si do të mbetet,
xha Share?

— Unë s'kam vajzë për të martuar, or shoku
Stavri — përgjegji ai, duke i hedhur kutinë e duha-
nit përpara.

— Është mirë që me këtë gëzim t'i gëzojmë edhe
zemrat e tyre, — shtoi mysafiri.

Share Gremi s'foli.

Hapi i nënë Diles u ndie të pragu. Ajo hyri e
para e pas saj Vita me Cenon.

— Paç faqen e bardhë, more burrë! Paç faqen e
bardhë! M'i tregoi Cenoja të gjitha. . .

Midis atij gazi, të dy pleqtë shtrënguan duart
e pastaj Share Gremi përqafoi të bijën.

— Vitë — i tha — fale babanë që e gënjyen të
tjerët e të ngarkoi me një barë aq të rëndë.

Vajza nga mallëngjimi i atyre fjalëve të papri-
tura u përlot.

*

* *

Edhe pak e do të gdhinte, po gjatë gjithë asaj
nate Share Gremi s'vuri gjumë në sy. Kthehej e rro-
tullohej në shtrat e as në njërin, as në tjetrin krah
s'gjente prehje e qetësi. Lloj-lloj mendimesh i zienin
në kokë e pastaj me radhë i dilnin para syve ato arat
e tij, që kishte menduar e kishte kujtuar se për jetë
të jetëve do të ishin vetëm të tijat e pas tij të bijve,
nipërve e stërnipërve të atij fisi e të asaj shtëpie.

— Eh! — psherëtiu dhe një herë.

E ashtu, prapë solli para syve lëndinën pranë shtëpisë, kopshtin plot pemë e në fund ato arat buzë kanalit, që i mbillte herë misër, e herë pambuk, apo grurë.

«Eh, çfarë toke!» psherëtiu.

Sa plane kishte bërë duke u mbështetur tek ajo tokë! Sa shpesh kishte ëndërruar korrje e të ardhura me bollëk! Sa herë e kishte përfytyruar veten me kuaj e bagëti, me lopë e buaca, e në fund edhe me një shtëpi që gjithkujt t'i binte në sy në fshat. Ja, kjo kishte qenë e gjithë ëndrra e tij!

Por tani, papritur e pakujtuar, ajo ëndërr po i shembej për çudi.

Dhe Share Gremi, duke e parë me sy këtë shembje, ndjeu një shtrëngim të fortë në zemër.

*

* *

Ende s'kishte aguar. Në dhomë nënë Dilja flinte e qetë.

— Lum ti, që s'kupton nga këto punë! — tha ai, duke vështruar të shoqen.

Kaq. Pastaj u ngrit, u vesh e doli. Me të kapërcyer pragun, ndezi çibukun e bëri përpara në drejtim të atyre arave të gjelbra!

Ecte ngadalë e i menduar, duke qëndruar herë-herë si për t'i zgjidhur ato mendime të koklavitura që i vërtitëshin në mendje.

E ja më së fundi dhe ajo toka e tij, ato arat me grurë. . .

U erdhi rrotull me radhë e në fund u ndal tek ajo

pemishtja që e kishte veselitur me duart e veta, e ia kishte zili një katund i tërë.

— Eh! — psherëtiu — as unë s'di si erdhi kjo ditë të të dorëzoj me duart e mia! — Pastaj u përhumbe për një çast, po në atë përhumbe fytyra e sekretarit i doli përballë. Iu bë sikur akoma ishin në konak të tij: ai duke e pyetur e mysafiri me durim e buzëgaz duke i shpjeguar tërë pyetjet dhe gjërat e paqarta që kishte.

Duke përfytyruar atë, humbi për disa çaste tek ajo bisedë e gjatë e mbrëmshme.

Dhe ja, papritmas, iu duk sikur ai me qortim e keqardhje po i thoshte:

«Sa keq, xha Share! Sa keq! Nuk e prisja nga ti një qëndrim të tillë.»

«Turp, baba! Turp!» — iu bë sikur po e qortonte edhe i biri.

E, në fund, erdhi e i mbeti para syve Hysniu. I hequr dhe i zbetë, si gjithnjë, me atë vështrimin e thellë e depërtues, duke i belbëzuar ngadalë:

«Sa keq! Kaq shpejt harrove se unë rashë për këto ditë?»

Dhe prapë iu duk sikur vështrimi i të birit iu qep në fytyrë. Atëherë një rrënqethje ia përshkoi shtatin e me zor u mundua ta mbante veten.

«E mori dreqi, e mori», tha më në fund i tronditur, po përsëri, pa mundur ta largonte nga sytë fytyrën e djalit të rënë.

Pastaj, me atë ankth në zemër, mori udhën për në shtëpi. Kur arriti, mysafiri që ngritur dhe po e priste.

Tani edhe dielli kishte nxjerë synë mbi Tomor.

— E, xha Share, si ndihesh sot? — pyeti miku pasi e përshëndeti ngrohtë.

Plaku, që s'e kishte larguar nga sytë fytyrën e djalit të rënë, psherëtiu.

— Më fal, or shoku Stavri! Të kam munduar shumë. Po kokët tona s'u gdhendkan kollaj!

Tjetri, me përzemërsi, i buzëqeshi dhe e përqafoi.

— Jo, or xha Share! Unë bëra detyrën. Tani pa humbur kohë le t'ia nisim së bashku si dikur. Bile nga ai krah që do t'ju duket juve më i përshtatshëm.

— Po! — tha plaku. — Unë tani, si dje në luftë, jam i tëri juaji! — dhe, duke shqiptuar këto fjalë, për herë të parë e ndjeu veten të çliruar nga ajo barrë që i qe dukur shumë më e rëndë se sa malet vetë.

*

* * *

Pas hyrjes së Share Gremit në kooperativë, brenda dy ditëve firmuan edhe të njëmbëdhjetë familjet e fisit të Gremëve. Ditën e tretë edhe shtatë nga ato të lagjes tjetër. Tani edhe numri i agjitorëve që rritur. Pothuaj secili nga ata që regjistrohesh bëhej edhe propagandues për bashkimin e tokave.

— Pa dale, — tha plaku i Gremëve. — t'i bëjmë hesap njëherë. Tetë dhe njëmbëdhjetë bëjnë nëntëmbëdhjetë, e shtatë sot, njëzet e gjashtë. Domethënë edhe njëmbëdhjetë shtëpi na mbeten jashtë. Unë kam besim, or bij, se gjer pasnesër edhe ato do të vijnë te shumica.

«Sa është çliruar!» mendoi sekretari me vete dhe, ashtu i gëzuar, duke i hedhur krahët e përqafoi.

Dy ditë më vonë fshati u mbledh për të festuar ngritjen e kooperativës. Edhe në çastet e fundit erdhën e u regjistruan edhe dy nga ata që kishin mbetur. Tani gjithçka kishte ndryshuar. Edhe sheshi ku do të bëhej mbledhja që zbukuroar me lule e flamuj të shumtë. Në mes që vendosur një tryezë dhe anash dy banga shkolle. Më tej, gazet popullore, me dy defe, një violinë e një gërnetë, që ia kthente me grykë.

— Dasmë, or Share! Ja, kësaj i thonë dasmë, — i tha Hekuran Rexha, që fluturonte nga gëzimi.

— Ke të drejtë, — ia ktheu tjetri duke i shtrënguar dorën. — Po kjo dasmë s'bëhet për ty e për mua, o Heke vëllai, po për ata, për ata! — dhe me gaz plaku i Gremëve shtriu krahun në drejtim të një grupi të rinjsh e të rejash që po kërcenin.

— Eh, e badhë si kjo ditë qoftë jeta e tyre, — uroi tjetri.

Veçse Share Gremi nuk e dëgjoi këtë urim. Tani sytë e tij kërkonin të shquanin të bijën midis atij grumbulli të gëzuar

Vita, e prekur nga mallëngjimi i të atit, iu hodh ndër krahë. Atë e bijë tani ishin të lumtur. Sazet kishin pushuar e njerëzit, burra e gra, genë mbledhur grumbull. Sharën e thirrën në presidium.

— Shokë! — u dëgjua zëri i njërit prej anëtarve të këshillit. — Kjo është një ditë e madhe për ne, — dhe heshti për një çast. — Pra, që pata fjalën, sot hapet një faqe e re sistematike në historinë e fshatit tonë. Për këtë qëllim ka ardhur dhe reziston midis nesh edhe vetë shoku Stavri Kondakçiu.

— Ç'do të thotë me fjalët reziston e sistematike?
— i tha sekretari Telo Banit me çudi.

Tjetri vuri buzën në gaz:

— Është njeri baballëk, shoku Stavri, po e ka këtë të metë. Kur vijnë të deleguar mundohet të përdorë fjalë të huaja, megjithëse nuk ua di kuptimin.

— Sii? — tha sekretari i çuditur edhe më fort dhe në çast e preu fjalën për ta dëgjuar.

Ndërkaq folësi, që e kishte marrë revan, vazhonte serbes-serbes.

— Kështu, që pata fjalën . . . në pyeçi për fjalimin e rastit, atë do ta insistojë vetë shoku Stavri. Unë vetëm ju lutem, si gjatë fjalimit ashtu edhe gjatë diskutimeve, të mbani qetësi dhe unë kam besim se ju qetësinë do ta mbani, mbasi ne gjithnjë kemi qenë në filarmoni. Këto kisha, sa për prezantim e hyrje. Për-sa u takon kolkuzioneve të mbledhjes, ato, si kurdoherë në fund, do t'i bëjë vetë shoku Stavri.

— More! — tha sekretari. — Ky të nxjerrka bojën me këto fjalët e tij pa kuptim!

Po tani folësi ishte duke i dhënë fund «fjalimit».

— Shokë, — tha në mbyllje, — tani e merr fjalën shoku Stavri Kondakçiu, i deleguar i komitetit të Partisë të rrethit.

Sekretari u ngrit e midis turmës së gëzuar shqoi Vita Gremin, që duartrokiste nxehtësisht.

Pasi pushuan duartrokitjet që zgjatën një copë herë, ai nisi fjalën. Foli shkurt e në fund, duke iu uruar fshatarëve që ta gëzonin për jetë kooperativën, i porositi ta ruanin nga armiqhtë.

Firmën e parë e hodhi Share Gremi.

— Unë s'di shkrim, or bir, — i tha Telo Banit, — po ma jep atë bojën të lyej gishtin e thuumë ku ta vë.

— Këtu, xha Share, — tha djali buzgaz.

Plaku e ngjeu e pastaj e mbështeti mbi letër.

— Me gëzim e faqebardhë, — tha sekretari duke u ngritur në këmbë e duke e tokur me të.

Në atë çast një valë gëzimi përshkoi të pranishmit, pastaj një breshër duartrokitjesh mbuloi tej e tej fushën.

Papritmas, Vita Gremit iu mbushën sytë me lot. Ajo u skuq e me turp u hoq mënjanë, që t'i fshinte.

— Ç'pate? — i tha i vëllai duke iu afruar.

— Kjo është ditë e madhe për mua, Ceno, — ia ktheu ajo, duke i futur krahun ushtarakut.

Po që nga presidiumi vështrimi i Telo Banit ra mbi të dy.

Ushtaraku i buzëqeshi, kurse ajo e skuqur në fytyrë hodhi sytë përdhe e diç ndjeu në zemër.

«Sa më kishte marrë malli!», iu duk se i thanë ata sy.

Ndërkaq, regjistrimi i anëtarëve vazhdonte. Di-sa nga ata që firmosnin, e, për të shprehur gëzimin që ndienin, ngriheshin e flisnin para masës.

«Me të vërtetë festë!» mendoi sekretari duke i hedhur një vështrim gazmor atij grumbulli të madh njerëzish.

Tani, si për çudinë e tij, edhe ata më të ngrysurit ishin çelur e flisnin serbes!

Telo Bani i dëgjonte e, kur mbaronin, ngrihej e u jepte dorën pa e fshehur dot gëzimin e thellë të atyre çasteve.

«Ka të drejtë — mendoi sekretari duke e vështruar me përzemërsi. — Ky e di ç'ka hequr për t'ia arritur kësaj dite!»

Po Teloja akoma vazhdonte me regjistrimet.

Hekuran Rexha u ngrit e buzagaz, si për shaka, iu ankua Telos.

— E pse, or bir, më paske lënë nga fundi? Apo si duket ne pleqtë s'ua mbushim syrin të rinjve?

— Të lamë, or xha Heke, që t'i vije kapak kësaj pune! — tha me mirëdashje një nga shokët që kishte zënë vend në tryezën e presidiumit.

— Kapakun duhet t'ia vënë Serjan Deda e Lazër Gori me shokë — ndërhyri Telo Bani, duke u hedhur nga një vështrim mirëdashës të dy shokëve, që akoma s'e kishin dhënë fjalën për të hyrë në gjirin e asaj familjeje të madhe.

Po ata ulën kokën pa kthyer përgjigje.

Tani pothuaj gjithshka kishte mbaruar. Vetëm nëntë familje kishin mbetur jashtë. Që të gjithë nga lagjia «Dokaj», Midis tyre edhe i riu Dine Skurraj. I skuqur në fytyrë ai kish zënë vend përballë Bajram Gjatovilit dhe Ethem Kobures.

Duke vazhduar, Telo Bani edhe një herë u drejtua nga ata të fundit:

— E, xha Serjan e xha Lazër, si thoni, t'ua shënojmë emrat?

I pari flakë në fytyrë, pa luajtur nga vendi, tha mbyturazi:

— Jo, shoku Telo, jo! Më vonë shohim e bëjmë. Hë për hë akoma s'e kam atë mendje.

— As unë hë për hë, or bir! As unë, hë për hë! — tha tjetri.

— Mirë! shtoi djali, duke i vështruar përsëri ngrohtë të dy. — Po ndonjë shok tjetër a e do fjalën?

— E desha edhe unë, or Telo! — tha Share Gremi, duke u ngritur me vështirësi. E desha dhe unë për t'i thënë nja dy fjalë që më kanë mbetur gozhdë në mendje e gozhdë në zemër.

Ndërsa ai çohej zëra u ndien në masë:

«Sharja! Sharja! Xha Sharja!»

Plaku priti sa heshtën.

— E kam me ty, or Bajram Gjatovili. — tha Sharja. — Dua të di ç'të pata bërë që ma punove kaq hidhur. Ç'pate me time bijë? Në i di ndonjë të keqe, hape gojën këtu përpara popullit! Po hape, ama, dhe mendohu për ato që do të thuash. Në se s'i ke nga vetja, siç më the dikur, atëherë thuaj, nga kush i ke? Po dije, ama, se njeriu për një nder rron! — dhe duke folur Share Gremi mori aq dallgë, sa duart zunë t'i dridheshin dhe sytë e skuqur sikur do t'i shkrepëtinin. Tani edhe fytyra i kishte marrë ngjyrën e flakës së zjarrit, ndërsa vetullat e trasha i qenë mbërthyer ligsht mbi shtegun e atij balli të gjerë të mbuluar me rrudha.

— E, Bajram, — tha sërish, — fol, kush të ka thënë se ime bijë harakopet me komunistët? Në qoftë ashtu, mos më thëncin Share Gremi, po s'ia preva kokën këtu para jush! Po, në qoftë shpifje, or Gjatovil, si do të më përgjigjesh, se ke ditë që me ke futur zjarrin në shpirt. Se desh më ndave nga shokët dhe nga Partia, or lugat! Se më hoqe bukën e gjumin, duke më bërë hasëm të fëmijëve të mi, or djall! . . . E tani, ja ku jemi sy për sy e ballë për ballë! Përgjigjmu; ç'ka bërë ime bijë?

— Të këshillova thjesht si mik, or Share Gremi e të thashë se të gjithë neve prindërve na takon të kujdesemi për çupat, se helbete, çupa janë! — tha Gjatovili duke u ngritur e duke lëvizur pak nga vendi. Tani tiparet i qenë ngurosur, ndërsa sytë e tij bojë hiri vështronin me ligësi plakun e Gremëve.

— Fol, po të them, e mos ma përdridh fjalën, Bajram! — ngulmoi për të tretën herë plaku i Gremëve.

«Qen, i biri i qenit, e kam fajin unë, që sta shtypa kokën atëherë, kur të kisha në duar!» mendoj tjetri me vete pa iu përgjigjur e pa ia ndarë atë vështrim keqdashës.

Share Gremi filloi ta humbte qetësinë.

— Do të më përgjigjesh a s'do të më përgjigjesh, or Bajram Gjatovili? Po të them për të fundit herë!

— Jo, — tha tjetri i zbetë. — Pse sheh ëndrra ti, unë s'kam pse dal në atë shteg që s'është aspak imi!

— Atëherë, prit më, or shpifës e gjarpër, që më farmakose zemrën! Që deshe të më nxije ballin në këto ditë pleqërie! — dhe me një tokmak në duar, duke dalë nga presidiumi, u derdh të hakmerrej, ashtu siç ishte hakmarrë dikur, kundër ish-të zotërve të asaj toke, ku Gjatovili gjithë jetën e tij kishte shërbyer si qahja e duhaxhi.

Po Telo Bani dhe Hekuran Rexha u lëshuan dhe e kapën menjëherë.

— U rrëmbyet, xha Share, — i tha djaloshi. — S'ia vlen ta fëlliqni dorën. Atë tani e njeh i gjithë katundi.

Share Gremi s'iu përgjigj. Ai akoma dridhej nga ai inat, që ditë me radhë i kishte ndezur shpirtin.

Tani pranë i qe afruar edhe sekretari.

— Jo, jo, kështu, xha Share! — i tha. — Ti ke të drejtë ta demaskosh në mes të gjithë popullit, pastaj ka ligje për të liqtë, mos ki merak.

Ai e ndjeu tonin qortues të atyre fjalëve.

— Desha të nxirrja dufin, or bir! — shfryu dhe me kurrizin e dorës, fshiu djersët që po i mbulonin ballin.

Sekretari pa fjalë i futi krahun dhe e çoi në pre-

sidium. Ai uli kryet, po prapë pa e hequr nga sytë fytyrën e Bajram Gjatovilit.

— Shokë, — e theu heshtjen Telo Bani. — Tani, a ka edhe ndonjë tjetër që do të flasë?

Po askush nuk foli nga ata që kishin mbetur jash-të këtij bashkimi.

— As ju, xha Gjergji, nuk kini gjë për të thënë? — shtoi djali duke e shikuar me ngrohtësi tjetrin.

— Mos ma merr për ters, po akoma s'ia kam takatin kësaj pune, more bir — tha plaku duke iu marrë goja.

— Po ç'ju pengon? A mund t'u thoni shokëve? Apo ndoshta nga fjala që mund t'ju ketë marrë ndokush, hyrja ju duket si «thyerje bese»?

Gjergj Mita s'u ndie. Po fytyra iu err e balli iu rruhd i tëri.

— Mirë, mirë, — shtoi djali duke e vështruar me keqardhje tjetrin. Pastaj, pas një heshtjeje të shkurtër:

— Po ju, shokë? — tha duke iu drejtuar një për një me emër të tjerëve. Po ndërsa atyre iu drejtua një për një, Bajram Gjatovilit dhe Ethem Kobures as ua ktheu sytë e as ua zuri me gojë emrat. E, si atyre, për ta lënë për në fund nuk iu drejtua as Dine Skurrajt. Ata që dëgjuan emrat, të heshtur e kishin nderë vështrimin për tokë. Bajram Gjatovili, i zbetë, u hodhi një sy vjedhurazi të gjithëve.

«Po të mbahet ky sfrac, prapëseprapë është një farë fitoreje» mendoj duke e ndier veten si mbi një barkë mes tallazit në det të hapët.

— E? — u ndie sërish zëri kumbues i Telo Banit. — Asnjë prej jush s'ka për të thënë ndonjë fjalë?

«S'po u ndahet i mallëkuari!» mendoj rishtas Gjatovili, duke iu thelluar urrejtja për Telo Banin. Pas-

taj, rrëmbimthi, hodhi një sy nga Dine Skurraj. Ai, kokulur, akoma heshte, përballë tij dhe Ethem Koburja.

I erdhi mirë. «E bëra sus konen! E desh atë fshikull në fytyrë» mendoi dhe befasi iu bë sikur i doli e gjallë para syve ajo skena e goditjes faqe Lazër Gorit e Serjan Dedës.

Po befasi u drodh e zemra i rrahu me forcë. Dine Skurraj duke ngritur dorën, kërkoi të fliste.

— I kam edhe unë dy fjalë, shoku Telo. Mendova të ngrihesha i fundit, po s'po më pritet. Do t'i them ashtu si ngjanë, si i dëgjova, si i pashë... Po do të lë edhe diçka pa thënë, për ta dëgjuar këtë të vërtetë edhe nga shokë të tjerë me të cilët bashkëpunova në këto ditë.

Ethem Kobures i ranë tespijet nga duart. Gjatovili nduku buzët me dhëmbë.

— Fol, fol! Ç'ke dëgjuar e ç'ke parë! — U ndie një zë vaje nga ai grumbull njerëzish që e kishin kthyer vështrimin nga djaloshi.

— Do të flas, Lume... Do të flas. Po bashkë me mua këtu besoj se do të flasin edhe të tjerë. Së pari, po e nis me xha Lazrin e xha Serjanin. Unë i dua dhe i nderoj ata, siç i do dhe i nderon i gjithë katundi. Ata më mbrojtën kur disa ditë më parë Ethem Koburja dhe Bajram Gjatovili më goditën në fytyrë sa më përgjakën.

Ethem Koburja dalldisi nga këto fjalë.

— Gënjen, shokë! Gënjen, kopuku!

Bajram Gjatovili, i zbetë, ktheu sytë nga Lazër Gori e Serjan Deda. Ata, me vështrimin mbërthyer për tokë, qenë bërë dhé në fytyrë. I dha kurajë qëndrimi i tyre. «Me siguri nuk do të tregojnë» mendoi me ve-

te dhe ashtu, disi më i përmbajtur se i pari, tha duke iu drejtuar Dine Skurrajt:

— Përse, more djalë, pse i ngatërron gjërat. Në qoftë se ju kemi qortuar ty e tët vëlla për atë që bëtë një vit më parë, këtë e bëmë për të mirën tuaj. . .

— Mirë, mirë, ju do t'ju dëgjojmë më vonë. Tani mos ia prisni fjalën Dines! — gjëmoi një zë nga populli.

— E drejtë, — tha Telo Bani prerë. — Kini durim gjersa të mbarojë Dinia. Dëgjuat? Kini durim gjersa të mbarojë!

— Të mbarojë apo të gënjejë? — turfulloi sërish Ethem Koburja, po kësaj radhe duke tundur grushtin në erë.

— Të mbarojë, dhe të ndihmojë për zbulimin e së vërtetës, — tha me theks edhe më të prerë Telo Bani.

Njeriut që kishte ngritur grushtin përpjetë iu tha pështyma në gojë.

— Më duket se çështja po hyn në tjetër udhë! — tha Gjatovili i trondiur rëndë.

— Dine! Vazhdo, Dine! — foli sërish Telo Bani duke i dhënë zemër djaloshit, që ia kishin prerë fjalën për të dytën herë.

— Pra, shokë, siç nisa të tregoja, Ethemi e Bajrami më goditën, sa më përgjakën në fytyrë. Ju do të thoni përse? Se më gjetën duke u folur xha Lazrit e xha Serjanit për të mirat dhe ndryshimet e mëdha të një kooperative ku kam qenë. Duhet të bashkohemi, po u thoshja, se s'ka rrugë tjetër shpëtimi për fshatarësinë veç asaj që tregon Partia.

— Për cilën rrugë e ka fjalën? — ma preu Ethemi duke marrë dallgë, — e cilën Parti po marrke nëpër gojë? Atë që yt vëlla i ktheu krahët duke dashur të

merrte për grua një bijë kulaku? Atë që ju nxori bojën si familje? Atë që në mbledhje të popullit jua bëri kurrizin më të butë se barkun? Pusht i pushtëve, dashke të marrësh më qafë edhe njerëzit e drejtë e të ndershëm, që janë në hall të tyre! — dhe, duke i kërcyer damari i ballit, ma ngjeshi në fytyrë. Pas tij edhe Bajrami. Unë u gjakosa keq. Xha Lazri e xha Serjani ndërhyjnë e më hoqën nga duart e tyre.

— Dëgjo! — më tha Bajrami — Më mos e zërë me gojë Partinë tonë të dashur. Larot ajo nuk i qas në sofër. Për ta ka pasur e do të ketë gjithnjë shkopin. Dhe, duke më kthyer, krahët: — Eh, o Lazër e Serjan — tha — t'ia tregoj varrit ç'më kanë parë sytë në Skorbinje! Është një fshat në rrethin e Elbasanit, midis Sulovës, Dumresë dhe Peqinit. Edhe atje, ca birbo si ky, ua mbushën mendjen një pjese të fshatit dhe i bashkuan tokat. Gjerdhe e kufij i bënë rrafsh brenda javës. Po ç'ndodhi në krye të vitit, pa? Ndanë vetëm nga gjysëm kile misër për ditë pune. Atëherë, nga halli, iu shkarkuan njëri-tjetrit. E prishën kooperativën, po s'po e gjenin dot fjalën për kufijtë e tyre të mëparshëm. Atëherë krisi dajaku: «Jo ma more, jo ta mora!» «Jo e kisha këtu e jo e kishe atje!» Ja, këtë kërkojnë birbot e kësaj kategorie, që kur ë shohin pisk kërcasin nga sytë këmbët e thyejnë qafën qyteteve, siç e bëri edhe i vëllai i këtij bukuroshi. Më plaçin sytë në u gënjej për këto që po u them. S'do të bënit keq të merrnit mundimin dhe të shkonit gjer në Skorbinje për t'i parë me sy e për t'i dëgjuar me veshë ato që pashë e dëgjova unë». «More, more»! I ra ballit xha Serjani, që ishte hutuar i tëri nga ai «rrëfim i zjarrtë» i Bajramit. Pastaj: «Lazër — i tha — po a e di se nja një mot më parë, kur po luftohej këtu për kooperativën që s'u ngrit, edhe mua ma

ka zënë veshi një fjalë të tillë? S'di nga erdhi e kush e pruri, por që e kam dëgjuar, ama, e kam dëgjuar me këta veshë!» — «Po si e dëgjove? Për në Elbasan apo për gjetiu?» tha tjetri. — «Po, po. Për në Elbasan, Lazër. Për në një fshat të Elbasanit». — «Ashtu?! Po, edhe vjet u fol se ishin rrahur për shkak të kufijve!» — «Po, po. Ashtu u fol.» — «Po atëherë, pse s'thua se fjala e Bajramit qenka rrumbullak e vërtetë?! Si, ore si? Edhe u rrahën? Zot na ruaj! Të humbasësh tokën e më në fund të bëhesh edhe gazi i dynjasë?!» — «Ëh! — psherëtiti Bajrami si i pikëlluar thellë. — Të rrihesh the, or Lazër? Të rrihesh, or mik e të rrihesh sa të bëhesh copë!» dhe, duke marrë hov nga heshtja dhe habia e dy të tjerëve u betua dhe u stërbetua se ato fjalë s'i luante as topi. «Tani, or Serjan, se ti je pak si më i hedhur, po deshe shko e fute kokën në atë lloj kulari të tyre!» — «Jo, or Bajram, vëllai, se akoma s'ma ka marrë zoti mendjen gjer në atë shkallë» — «As mua, — tha xha Lazri i prerë në fytyrë, — kësaj i thënkkan të vrasësh veten me duart e tua!»...

Tani masa që elektrizuar. Dinia vazhdonte të fliste. Bajram Gjatovili, duke e shikuar me kanosje djaloshin, shkumëzonte. Tjetri, Ethem Koburja, si më i krisur që ishte, dalldisi edhe një herë:

— Mjaft! Mjaft me këto gënjeshttra! T'i mbyllet goja shpifësit!

Dhe ashtu siç ishte provoi të ngrihej. Po Telo Bani e uli.

— Ki durim! Ki durim sa të mbarojë!

— Mbarova, shoku Telo, mbarova, — u dëgjua rishtas zëri i djaloshit që qe bërë prush në fytyrë. — Tani, edhe dy fjalë. Po jo për të tjerët, po për vete e për tim vëlla. Fshati më njeh. Jam biri i një të var-

fri që luftoi si partizan dhe vdiq si njeri i Partisë. Mbas vdekjes së babait im vëlla na e turpëroi shtëpinë. Dëshu një vajzë nga fshati fqinjë dhe i dha fjalën. Në atë kohë familja e saj, megjithëse me origjinë agallarësh, s'kishte ndonjë emërtim për të keq, po pak më vonë i ati u cilësua kulak nga pushteti. Atëherë ne në familje e shtrënguam të hiqte dorë. Por ai nga sedra nuk desh të dëgjonte, duke thënë: «Unë u fejova kur i ati s'kishte ndonjë njollë». Kjo që përgjigjja që u dha në fillim edhe shokëve të organizatës së rinisë. Pastaj, ju i dini të dy mbledhjet që u bënë nga rinia dhe nga fshati, ku u kritikua rëndë ai dhe ne si familje që kishim heshtur para një veprimi të tillë. Vetëm nga ajo goditje ai kuptoi se sa rëndë kishte gabuar. Kërkoj ndjesë dhe u nda prej saj që atë ditë, duke u larguar, nga turpi e sedra, edhe vetë nga fshati. Tani, ju e dini se ku punon. Po njolla nuk mund të lahej me atë ikje. Ajo i qëndron në ballë atij, mua, gjithë familjes sonë. Unë e ndiej atë se si më zbret nga balli e m'i err sytë! Kjo është edhe arsyeja që kokullur edhe në këto ditë u kam qëndruar larg shokëve. Përsa i takon bashkimit të tokës unë do të isha njeriu më i lumtur i këtij fshati sikur shokët të më pranonin. Babai im për këto ditë pat luftuar. Ja, këto kisha, shoku Telo. Këto kisha, shokë. — Dhe u ul.

— Ty s'ka pse mos të të pranojë fshati, — tha Telo Bani, duke i shënuar emrin.

— Të lumtë, Dine! Të lumtë! — u dëgjuan zëra nga masa. — Ti ia hoqe kallajin ndryshkut, duke e lënë, ashtu siç është: ndryshk!

— Nuk e di, — u përgjigj Dinia që porsa kishte mbaruar së foluri, — po besoj se në këtë mbledhje të fshatit do të ketë të tjerë që do të dinë gjëra shumë më të rëndësishme nga ato që përmenda unë. Dhe këtu

s'e kam fjalën vetëm për xha Serjanin e xha Lazrin, po edhe për të tjerë...

— Të flasin, të flasin Serjani e Lazri!

Po, befas, një djalosh u çua më këmbë, duke ia marrë fjalën nga goja parafolësit.

— Shokë! — tha që në krye. — Ndofta jam ndër më të rinjtë që marrin pjesë në këtë mbledhje, po do t'u lutesha xha Serjanit, xha Lazrit, të gjithë juve, të flas para tyre. Ndofta ato që do të them do t'u hapin shteg ayre që kanë mbetur larg këtij bashkimi. E, në këtë grup, bën pjesë edhe familja ime.

— I kujt është ky i ri? — i pëshpëriti sekretari Share Gremi, që i qëndronte përkrah.

— I Gjergj Mitës, — tha plaku.

— Si? As ai s'paska pranuar të bashkohet me shokët?

— Jo, — tha Share Gremi. — Është një nga ata të lagjes së përtejme, fqinjë me Bajramin dhe Ethemin.

— Le të flasë! — tha sekretari, duke iu drejtuar Telo Banit. Le të flasë!

— Faleminderit, — tha djali duke kthyer fytyrën nga presidiumi. — Shokë, — vazhdoi, me vështrimin nga masa, — të më falë im atë, që po e marr fjalën përpara tij. Të më falë gjithashtu, që sot, për herë të parë në jetën time, po ngrihem e po flas kundër tij. Por këto që do të them tani ia kam thënë dhe atij. «Po u ndave nga shokët, nga Partia, unë do të de-tyrohem të ndahem prej teje» i kam thënë. Po kush po më ndan mua nga im atë, apo tim atë nga rruga që tregon Partia? Bajram Gjatovili dhe Ethem Koburja, shokë! Me po ato fjalë që mashtruan edhe Lazër Gorin e Serjan Dedën. Unë, si edhe Dinia, që vep-ruam së bashku gjatë këtyre ditëve, jemi dëshmitarë

të gjithë asaj pune të ndotur, që nga çasti që shkeli ekipi këtu. S'ka pasur natë që Bajrami dhe Ethemi s'kalonin tek ne e tek dy familjet që kishim pranë. «E? — thoshin sa futnin kokën. — A u erdhën sot Telo Bani me ekipin? Ç'ju thanë? Po ju, si iu përgjigjët? Bravo! Ju lumtë! Atëherë dëgjoni: Po u erdhën prapë nesër do t'u përgjigjeni në këtë mënyrë... Po t'ju thonë ashtu e ashtu», do t'u përgjigjeni: «Kështu e kështu e kështu!» E qartë? E qartë! Dakord? Dakord! Atëherë, dorën, shokë, dhe mirëupafshim nesër mbrëma! O burra, sa ta hedhim dhe këtë valë!»

Dhe vërtet të nesërmen Bajrami dhe Ethemi na gjendeshin në derë. Përsëri me po ato fjalë. Mbrëmë, pa u vënë re as nga babai, i shtyrë nga Dinia, i cili kishte ditë që e bënte këtë punë, iu qepa tinës pas atyre për të parë se vinin vetëm tek ne e tek dy fqinjët pranë, apo edhe gjetiu? Dhe, ku thoni ju se shkonin, shokë? Tek të gjithë këta që kanë mbetur jashtë këtij bashkimi të fshatit tonë e tani qëndrojnë kryeulët këtu. Ja, kjo është puna e tyre në këto ditë... S'kam fjalë tjetër. Veçse, si i ri, kërkoj që fshati t'i gjykojë e t'u japë dënimin e merituar si përçarës e sabotatorë.

— Gjergj — tha Teloja — duke iu drejtuar të atit të djaloshit. — Ç'ju thua fjalëve të tët biri?

Tjetri, i nxirë në fytyrë, psherëtit. Dhe, ashtu i tronditur, u mundua të ngrihej. Po nuk mundi as të ngrihej, dhe as të hapte gojën.

— Fol, fol ndenjtur — ia bëri tjetri që nga presidiumi.

Ai u drodh për një çast. Pastaj:

— Janë ashtu si i tha Caci, more bir! S'di si m'i zunë sytë e më mashtruan djajtë! Tani, me turp, ju

lutem mos bëni atë që bëra unë. Pranomëni të bashkohem me shokët, me djalin! — dhe uli kryet.

Djalit i ranë lot nga ai pohim i çiltër i të atit. Masa e prekur dhe e revoltuar shikonte tani me kanosje nga të dy përçarësit.

— S'e paskan pasur vetëm me mua — mendoi Share Gremi, duke parë fytyrat dyllë të verdha të Ethem Kobures dhe Bajram Gjatovilit.

— Mirë, — e prishi heshtjen Telo Bani. — Masa kërkoi pak më parë të flisnin xha Lazri e xha Serjani. Edhe unë do të dëshëroja ta dëgjojmë fjalën e tyre.

— Edhe unë — tha Vita Gremi me vete, duke i hedhur një sy rrëmbimthi djaloshit që po drejtonte zhvillimin e asaj mbledhjeje të zjarhtë.

Befas vështrimet e tyre u kryqëzuan. Ajo e skurur uli kryet.

— Telo, bir, — tha Lazër Gori që, posa qe ngritur. — Të gjitha janë të vërteta, ashtu si i tha Dine Skurraj. Bile më të zeza nga ç'i tregoi ai. Na gënjeu dhe na futi në pus i paudhi. Na gënjeu, se kurrë s'kemi ditur të gënjejmë. I besuam për Skorbinjen e për të gjitha të tjerat, deri te nderi i çupave dhe i grave në kooperativë. Dhe gra e çupa kisha edhe unë, kishte edhe Serjani, ashtu siç kanë të gjithë. Po për këto do të ishte më mirë të përgjigjej vetë Ethem Koburja. Këto kisha. Tani, shënomëni emrin, more bir, e falmëni mua plakun për shqetësimin që ju dhashë! — dhe u ul.

— Xha Lazër — u ndie një zë vajze nga masa — po Bajram Gjatovilin pse e ndatë nga Ethem Koburja?

— Vitë, bijë! — tha plaku. — S'di as unë pse s'e përmenda. Por ata janë të pandarë, moj çupë, në të gjithë këtë batak ku deshën të na hidhnin. Bile

Bajrami një çikë më shumë se ai që përmenda. Në djall u vaftë shpirti që të dyve!

Telos i erdhi mirë që ajo më në fund filloi të çelej dhe të fliste. E po ashtu edhe sekretarit.

— E dëgjove? — i pëshpëriti në vesh të atit. — Ajo ka të drejtë më shumë se kushdo tjetër të ngrihet kundër tyre.

Plaku tundi kryet.

— Po, or bir. Jo vetëm kundër tyre, po edhe kundër meje, që i paskam hyrë aq fort në hakë...

Sekretari, pa folur, i hodhi krahun Share Gremmit. Pastaj, dikush tha:

— Po flet Serjan Deda.

— S'kam çfarë t'ju shtoj atyre që tha Lazri — tha tjetri i zbetë. — Më errën ballin e më helmuan zemrën, djajtë. Dëgjuat? Më helmuan! Tani, or Telo, në ka vend edhe për njerëz si unë, më shëno emrin, or bir, në atë listë! — dhe heshti.

— Po ju shokët e tjerë? — pyeti sekretari, duke iu drejtuar atyre që ende s'e kishin dhënë fjalën.

Me përjashtim të Qemal Semanjakut dhe Sif Derdimenit, të gjithë të tjerët, duke i vështruar rëndë të dy përçarësit, kërkuan të bashkoheshin me shokët.

Telo Bani shënoi emrat e tyre.

— Po ti, xha Qemal? — pyeti në fund sekretari.

— Më vjen turp, or shoku Stavri, që sot s'kam gojë të të përgjigjem. Po këto që do të të them tani ua kam thënë edhe Telos e shokëve që ditën e parë që erdhi ekipi. Jam vetë i shtatë e që të gjithë me moshë që presin bukë nga krahët e mi. Dy djemtë që kam për punë, shokët e dinë, i kam në ushtri. I madhi sivjet lirohet. Tetë muaj më vonë do të jetë këtu. Ja edhe lutja! — dhe nxori një letër nga xhepi — E kam bërë gati dhe po e jap që tani. Në vjeshtë unë do të jem

me fshatin. Asgjë s'më ka ndarë nga shokët dhe nga Partia ndonjëherë dhe asgjë s'do të më ndajë.

— Po, po — u dëgjua një zë nga masa. — Ai e ka njëfarë halli...

— Nejse — tha sekretari pa u shtyrë më tej. Kurse me vete mendoi: «Punë konceptesh».

Pastaj, Telo Bani hodhi vështrimin nga njeriu i fundit që kishte mbetur, nga Sif Derdimeni, por nuk e cyti:

— Pa të qeshim një çikë — i pëshpëriti një i ri shokut që kishte përkrah dhe, duke ngritur zërin, foli:

— Po ti, Sifi, ç'ke për t'u thënë fshatit dhe sho-këve?

«Na hapi punë» mendoi Teloja, duke e vështruar ngultas e me shqetësim njeriun që posa qe ngritur.

— Me mua e ke ti, ëre? Jo, ëre, jo! Indrivid e kam unë atë timen, ëre Lili, indrivid! E ëre, pse m'i dredh buzët? Të kujtohet ai i komitetit kur më tha mua: merri tapitë, ëre, se ishe i shtypur, po tani e tutje indrivid për jetë ëre, Sifi, indrivid për jetë!» Mirëpo, do ti, ëre Lili, që qysh atëherë më ryri në qef mua indrividllëku? Jo, ore jo! S'i luaj unë nga fjala atij të komitetit, ëre!

Sekretari, që s'e njihte, po e shikonte me habi.

Tjetri, që é kish cytur pak më parë, përsëri i futi edhe një pickatë për ta ndezur edhe më keq.

— Do të hysh, ore Sifi, do të hysh se s'bën!

Njeriu i cytur, prapë kërceu.

— Jo or jo! Nuk e ha atë koqëz ulliri unë, ëre!

Sekretari u pre në fytyrë.

— Kokërr ulliri?! Ç'kokërr ulliri thoni? — tha me seriozitet, duke e vështruar ngultas në sy tjetrin.

— Qysh, ëre, ç'koqëz ulliri? Po kë kërkon ai, ëre,

të fusi në koprativë? Mua?! Mua që ma kanë zaptuar gruan xhindet?! Pyet, ëre, po deshe. Vetë hoxha i Sukut ma tha me gojën e tij: «Shtatë xhinde ta kanë bërë zap, ëre, i shkreti Sifi. Katër t'i ka turka, dy kaurka dhe një çifutkë. Turkat ia largoi i varfri. Kaurkave — ma tha si mik — s'u vij dot rrotull, ëre Sifi! Ato i bën zap vetëm prifti i Ardënicës. E çova edhe tek ai, që të pata fjalën. Ma mbajti katër ditë e katër net. Ta lëshuan — më tha — po i ka mbetur edhe një: ajo e çifutkave. Me to di të merret vesh vetëm një prift në Shkodër. E, ëre, t'i shoku që ke ardhur nga qyteti, e ke ndonjë mik t'ia gjejmë anën edhe atij të Shkodrës?

— Qenka teveqel! — i pëshpëriti sekretari Telo Banit. Pastaj:

— Mirë, mirë, shok! — i tha — Ulu, ulu!

Masa shkulej së qeshuri.

— Shokë, pushoni! — thirri dikush nga presidiumi.

— Pushoni! — thirri edhe Telo Bani.

Po njerëzit akoma shkuleshin së qeshuri.

— Shokë! — tha rishtas Teloja, duke e ngritur zërin edhe më lart për t'i dhënë fund atij gazi — Dhe priti.

Të qeshurat pushuan.

— Tani edhe unë i kam dy fjalë. I kam me ty, Bajram Gjatovili, me ty Ethem Koburja, dhe me ty Thimio Duçka. Çohuni!

Bajram Gjatovili e Thimio Duçka u ngritën të parët. Njëri i zbetë e tjetri i nxirë në fytyrë. Pas tyre, si me përtesë, u çua edhe Ethem Koburja. Ai, i ngrysur, akoma kishte një vështrim kanosës, si ndonjë bishë e plagosur për vdekje. Gjatovili i hodhi një sy dhe i erdhi çudi me mendjelehtësinë e tij, që akoma mundahej të mbahej përpara atij detit në tallaz

e furi të plotë: Dhe ashtu, në atë marramendje, iu duk sikur sheshi i shkollës u rrotullua e pastaj edhe ajo masë njerëzish që i kishin mbërthyer sytë drejt tyre.

— Bajram, Ethem dhe Thimio! — tha Telo Bani duke vazhduar fjalën. — E dëgjuat popullin? Ai ju gjykoi, ai ju bëri pretencën dhe prapë po ai do të japë edhe vendimin për atë që bënë kundër tij. Dëshët me intriga e mashtrime ta futnit në rrugë pa krye e ta merrnit pas qerres suaj, po tani a e shikoni se çfarë po merrni me vete? Vetëm hijet tuaja të zeza. Këtë përgjigje si popull, në ju kujtohet, disa ditë më parë jua dha plaku Ramë Sula: «Ti s'bëre asnjë faj, more bir, — i tha ai të deleguarit. — Dhe ja ku e them në këtë mbledhje: për sivjet unë kisha menduar të mos hyja. Po meqë erdhi puna kështu shkruamani emrin edhe mua plakut përkrah emrave tuaj. Dhe çështja me një durim e urtësi të tillë do të fitohet, se s'ka gjë që ka thënë Partia dhe s'është bërë.» Dhe ja ku i doli fjala këtij njeriu të thjeshtë të popullit. Po, megjithatë, njerëzit duan të dinë: «Ç'mendon ju tani për gjithë ato që bëtë? Përse e vutë në shenjë nderin e tyre? Përse e lënduat në atë mënyrë një njeri aq të mirë e aq të drejtë si Share Gremi? Përse ajo kosorja, ato shatat dhe ata hunjtë në atë mbledhjen që fshati ynë s'ka për ta harruar kurrë? Që të përleshej masa me ekipin e të diskreditohej çështja e kolektivizimit në fshat, në rreth e ndoshta në gjithë vendin? Sigurisht. S'dua të përsëris ato që me radhë ua përmendën shokët këtu. Po para se t'ju jap fjalën, kam edhe një pyetje: «Ku bie ajo Skorbinja juaj e famshme në rrethin e Elbasanit, që e përdorët si gogol vjet e sivjet e që njerëzit të hutuar e gojëhapur mendonin: «Diç dinë

Bajrami dhe Ethemi! Ata janë të bredhur . . . » — Dhe, duke iu drejtuar njërit prej arsimtarëve, Telo Bani e luti të sillte pa vonesë ndonjë nga hartat që kishte shkolla.

Tjetri shpejtoi dhe e solli.

— Eja, Bajram, e na i trego tani se ku bie! — dhe ashtu, duke e vështruar ngultas tjetrin, shtriu hartën mbi tryezën ku kishte zënë vend presidiumi.

— Nuk ka Skorbinjë, shoku Telo. Unë dhe Ethemi e shpikëm nga koka.

— Ashtu është — theksoi tjetri me zemërim. — E shpikët nga koka, ashtu si shpikët edhe shumë e shumë gjëra të tjera të paqena, që u përmendën këtu nga shokët. Po tani përpara fakteve dhe popullit a i pranoni ato që thanë kundër jush Share Gremi, Dine Skuraj, Lazër Gori, Serjan Deda, Anastas Mita e shokë të tjerë? Të pyes ty të parin, Bajram!

— Po. I pranoj, shoku Telo. Kam gabuar shumë rëndë . . . Kërkoj të falur.

— Edhe unë — tha i dyti, që tanimë dridhej nga një tronditje e thellë. — S'di si më futën Ethemi dhe Bajrami në këtë udhë pa krye. Ju lutem, po të mundni, ma shënoni emrin në atë listë. Për hir të fëmijëve . . . Për hir të fëmijëve, shpëtomëni nga ky batak ku kam hyrë . . .

— Edhe mua, po qe e mundur — tha me gjysmë zëri Bajram Gjatovili, pa i lënë kohë Telo Banit që t'i drejtohej të tretit.

— Burracaku! — shfryu Koburja me zë të ulët, duke zier thellë në vetvete. Pastaj, vëngër, hodhi një vështrim therës nga Gjatovili.

— Ethem — tha Telo Bani — po ti ç'ke për t'i thënë popullit?

Ai lëpiu buzët e thara, që s'po i çelëshin.

— Dëgjo, — tha — Dëgjo, Telo Bani! Ta dija kë-shtu s'të vija në këtë mbledhje. Tokën s'e kam xhaba nga askush, po timen, ma kanë lënë babai dhe gjyshi. Dhe përgjigjen ta kam dhënë qëkur. Besoj se nuk e ke harruar rrugën e asaj bretkocës. Ajo është edhe rruga ime, edhe përgjigjja ime! — Pastaj syve të tij, që shkrepnin nga urrejtja e zemërimi, iu bë sikur honi që e ndante u thellua edhe më shumë dhe Telo Bani me presidiumin u larguan aq tepër prej tij, sa me sy tanimë s'po mundej t'i dallonte si më parë.

— E qartë — tha djali — Atje do të ngordhësh. Te bretkocat e me bretkocat, Ethem Koburja...

Të revoltuar nga ato fjalë, një grumbull njerë-zish brofën e zërat buçitën sa sheshi i shkollës gjë-moi e pylli aty pranë oshëtui:

— Ethem Koburja të shpallet kulak!

— Ethem Koburja të shpallet kulak!

— Ja zëri i popullit — theksoi djali, duke iu drejtuar njeriut që kishte mbetur përtej atij honi. Pastaj, duke u kthyer nga masa:

— Shokë, — tha — I dëgjuat? Kemi dy kërkesa për pranim. Të Bajram Gjatovilit dhe Thimio Duçkës. Ja ku e them që në krye: Votën time do ta kenë kundër si njëri dhe tjetri, megjithëse është zëri i popullit ai që do të vendosë. Pra, shokë, le t'i marrim një nga një. Kush është për pranimin e Bajram Gjatovilit?

Asnjë s'ngriti dorën.

— Kundër?

— Të gjithë! — u dëgjua zëri i Lume Banit, që vullnetarisht ishte ngritur për të numëruar votat.

Pastaj:

— Shokë — shtoi — Kush është pro për Thimio Duçkën?

Po para ngritjes së duarve, plaku Ramë Sula u çua dhe kërkoi fjalën.

— Bir, — i tha Telos — para se të votojmë për të, do të ishte mirë t'i thoshnim dy fjalë. Ndërsa dy të tjerët kanë jetuar tërë jetën si agallarë e qahallarë të Vrionasve, Thimioja, ka qenë njeri i varfër, pa asnjë dynym tokë të tijën. Tokën ia dha kjo Parti, ia dha ky pushtet. Ai është punëtor i palodhur dhe vuri dhjamë në këta vjet mbas Çlirimit dhe i harroi shokët e tij të vërtetë, sërën nga vinte, klasën. Megjithatë unë mendoj se duhet bërë një farë dallimi midis dy të parëve dhe këtij të fundit. Ja, këto kisha.

Pas Ramë Sulës, edhe dy të tjerët që e morën fjalën më pas e mbështetën mendimin e të parit.

— Mirë, — tha djali që drejtonte, — në votë. Kush është pro pranimit të tij?

Lume Bani numëroi votat.

— Shtatëmbëdhjetë.

Kundër?

— Gjashtëmbëdhjetë.

— Fiton — tha Telo Bani, duke e shikuar ftohtë e nga lart poshtë njeriun që tanimë ishte pranuar.

Tjetrit, nga e papritura, mornica ia përshkuan shtatin, pastaj lotët i rrëshqitën mbi fytyrën e rreshkur e plot rrudha. Dësh, po nuk mundi të fliste.

Bajram Gjatovilit i kishte rënë hije të vdekuri, ndërsa sheshi akoma dukej sikur i vinte për qark. Po zëri i fortë i Telo Banit e solli në vete:

— E kam me ju Ethem Koburja dhe Bajram Gjatovili! Ç'prisni akoma? Qërohuni! Qërohuni që këtej!

I marramendur, Gjatovili ktheu krahët i pari. Pastaj edhe tjetri, pasi i hodhi një vështrim për buzës Telo Banit.

— Prapa diellit! Prapa diellit! — u dëgjuan zëra

nga masa. Pastaj një burrë doli nga grumbulli i atyre njerëzve të gëzuar.

— Telo, bir! Telo, bir!

— Urdhëro, xha Qemal — tha djali duke u kthyer drejt tij.

— Ma shëno, more bir! Ma shëno emrin edhe mua! S'di si m'u dukërka vetja tek po e shoh se kush mbeti në këtë krah të njollosur. S'do të bëhet qameti për tetë muaj sa të më kthehet djali. Drojtja është e madhe, more, Telo, po me siguri edhe më mirë ka për t'u bërë me shokët...

— E dija që s'do të na ndaheshe, xha Qemal — dhe gazmor Telo Bani e rroku me krahët e tij të fuqishëm njeriun që po e mbyllte atë bashkim.

I qeshur, edhe sekretari, i dha dorën dhe e përqafoi.

Pastaj u procedua për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë. Fshati, me unanimitet, caktuan për kryetar të kooperativës njeriun që kishte luftuar aq shumë për këtë bashkim, komunistin Telo Bani.

Tani gjithshka kishte marrë fund.

— Orkestra, orkestra! — u dëgjua një zë vajze.

Gërneta e violina ia dhanë menjëherë. Pastaj:

— Valle! Valle, shokë! — thirri Lumturi Bani, duke ia nisur vetë e para:

Ju të rinj e ju të reja,

I madh është numri jonë...

Një çast dhjetëra e dhjetëra vetë nga rinia e të moshuarit u derdhën e zunë duart. Vallja shpërtheu. Zërat, të shoqëruar nga tingujt e orkestrës, buçitën.

— Botë njerëzish të rinj! — i tha sekretari Share Gremit. — Po ne a nuk do të bashkohemi me ta?

— Po unë s'di të kërcej, or shoku Stavri.

— Si të dish, xha Share! Do të mësojmë duke i hedhur këmbët pas tyre.

— Po, po, more bir, pas tyre! — dhe ashtu i qeshur e bashkoi dorën me atë të sekretarit që qëndronte e shtrirë. Pastaj, të dy, u shkrinë midis atij grumbulli që vallëzonin e këndonin me gjithë shpirt:

Haj t'punojmë,
Djersa të kullojë,
Të ndërtojmë
Shqipërinë e re...

— Po Vita e Cenoja ku janë?

— Ja! Ja! — tha plaku, që posa i kishte vënë re.

— Vitë! Vitë e Ceno! — thirri sekretari. — Ejani! Ata erdhën e zunë duart përkrah tyre.

— Ju faleminderit, shoku Stavri.

Ai e pa ëmbël vajzën.

— Po Teloja? — i tha Cenos. — Thirre! Thirre dhe atë të vijë përkrah nesh. Apo jo, xha Share? S'besoj të kesh ndonjë kundërshtim.

Plaku u skuq.

— Jo, more shoku Stavri. S'kam pse të kem kundërshtim. Ai është djalë xhevahir.

Pas pak, duke hyrë midis tyre, Telo Bani i dha një dorë sekretarit e tjetrën Share Gremit.

Po nga fundi i asaj valleje, që po zgjatej pa mbarim, plaku i Gremëve e ndjeu veten ngusht.

— Shoku Stavri — tha — Unë po tërhiqem. Helbete, pleqëri i thonë! — dhe doli.

Teloja e Vita mbetën përkrah njëri-tjetrit.

— Kështu do të dëshëroja t'ju shihja për tërë jetën! — tha sekretari i entuziazmuar nga lumturia e

atyre të rinjve që kishin vuajtur aq shumë. Pastaj:
— Ju vazhdoni — shtoi. — Unë po shkoj t'i bëj shoqëri xha Shares. Ju e dini, e kam mik të vjetër.

Ata e vështruan ëmbël e me mirënjohje. Dhe ashtu, gjer në të kthyer të asaj dite, kënga dhe vallja s'pushuan dhe ata nuk i ndanë duart nga njëri-tjetri. Share Gremi, i përtërirë, i shikonte e fluturonte nga gëzimi. I dukej tani sikur gjithshka që i kishte prekur nderin e sedrën ishte vënë në vend plotësisht. Kurrë, kurrë s'e kishte përfytyruar një mbarim me një fund aq të turpshëm për armiq të tij më të egër e më dinakë.

— Shoku Stavri! — tha, duke vënë re sekretarin që i ishte afruar — Sonte Share Gremi ka festë. Rreth sofrës do të ulemi e do të pimë bashkë. Ndryshe nga netët e tjera...

— Po — tha tjetri. — Por sonte, xha Share, kanë festë edhe Vita me Cenon! Edhe ai djaloshi i ndershëm e i drejtë, Telo Bani! Po, edhe ai plaku i hekurt, Hekuran Rexha, që s'iu nda Telos e të tjerëve asnjë ditë!

— Po, more bir. Edhe ata të urdhërojnë... Edhe ata të urdhërojnë në atë sofër! — pastaj, duke kthyer fytyrën nga e shoqja, që e kish përpirë ajo valle e të rinjve:

— Grua! Grua, moj! — i thirri.

Ajo shpejtoi e iu afrua.

— Dëgjo! Sonte ka festë Share Gremi! Sonte ka dasmë e mysafirë!

— E tyrja është shtëpia e mirë se të na vijnë, more burrë! — tha ajo duke fluturuar edhe më shumë nga gëzimi.

— Dëgjo! Merre edhe Vitën dhe përpiquni të më nderoni! More vesh? Përpiquni të më nderoni! — Dhe

me sy, mbas pak, i vuri re të dyja tek nxitonin drejt shtëpisë. S'foli, po në atë heshtje ndjeu një gëzim që s'e kish ndierë kurrëndonjëherë. Dhe ashtu i çelur e ndoqi me sy të bijën gjer tek kthesa e fundit.

«Flutur e babait! — tha më në fund — S'di a do të më falësh mua plakun!»

*
* * *

Tri ditë më vonë të dyja brigadat e kooperativës së Ilirasit filluan betejën. Puna nisi me prishjen e gjerdheve e të kufijve.

— Vitë! — i tha Telo Bani duke iu afruar — Dësh na ndanë edhe për pak. Më duket si ëndërr kjo ditë!

— Dëshën, — tha ajo — por tani ja tek jemi përgjithmonë bashkë. — Dhe e lumtur i buzëqeshi.

Ai i hodhi krahun mbi sup:

— Dëgjo — i tha — a e merr me mend se si do të jetë e nesërmja e fshatit, e sidomos e këtyre të fushës, në Myzeqenë tonë?

— Sigurisht, disi do të ndryshojë, Telo.

— Jo do të ndryshojë... po s'do të ketë asgjë të përbashkët me këtë që shohim sot unë e ti — tha duke tretur vështrimin në largësi — Këto katunde me shtëpi të shpërndara e në shumicë kasolle, mbas dy apo tri dekada vitesh do të bëhen qyteza të lulëzuara.

— Çfarë?! — mermëroi ajo me hëbi.

— Po, po, Vitë! Me planimetri e rrugë të reja, me klube e shtëpi kulture, me magazina popullore e qendra sanitare, çerdhe, kopshte, sheshe sportive...

— Ti qesh — kundërshtoi ajo, se... — dhe nuk e mbaroi fjalën nga që nuk dinte ç'të thoshte.

— Po, Vitë, po... E në përgjithësi atëherë, me një masë njerëzish e sidomos një rini të kulturuar që do të jetojë ndryshe duke i marrë këtë dhe maksimumin e asaj që mund t'i merret. Atëherë edhe kandilët do t'ua kenë lëshuar vendin llampave elektrike. Atëherë, edhe për ujë të piri, ti dhe shoqet e tua s'do t'i ktheni sytë nga lumenjtë, po gjeologët kanë për ta gjetur ujin e pishëm kudo që të jetë në thellësitë e këtyre fushave e secilit nga ne si ndër qytete do t'i vijë rubineta në derë. Atëherë, Vitë, edhe ndryshimet fshat-qytet kanë për t'u ngushtuar shumë, gjersa një ditë të mos ekzistojnë fare.

— Po më çudit! — tha ajo më në fund e shtangur nga habia. — Më çudit edhe serioziteti me të cilin m'i the gjithë këto fjalë. Kulme të tillë është e pamundur të arrihen.

— Këto që thashë, Vitë, s'i kam nga vetja, po i kam dëgjuar me veshë, në një bisedë që u bë me kuadrot e fshatit në aparat të KQ të Partisë. Foli komandanti, Vitë.

— Shoku Enver? — tha ajo e habitur edhe më shumë.

— Po. Ai vetë. E kur flet ai, do të thotë se ky është objektiv i Partisë. Thuamë, ç'ka thënë e s'është bërë?

— Të gjitha janë bërë — tha ajo, sikur të zgjohej nga një vegim i bukur, që s'të bëhet për t'iu ndarë.

— Kështu, pra. Atëherë edhe qyteti ka për t'i kthyer sytë më shumë nga fshati. Sidomos rinia! Unë jam i bindur për këtë. E ku ka gjë më të bukur se të punosh atje ku e sheh me sy krijesën tënde të gjallë! Toka është nëna dhe djepi i të gjitha të mirave dhe bukurive në jetë...

Ajo e heshtur, duke i shkëndijuar sytë nga gëzimi, u mundua ta përfytyronte atë kohë, me ato ndry-

shime të papara. Po befasi diç e solli në vete. I ati atë çast posa kishte dhënë ballë nga Mezhda e Kumeve. Të dy hodhën vështrimin andej.

— Babai! — tha ajo. — Më vjen keq, po duhet të largohem, Telo.

— Jo! — kundërshtoi ai i qetë. — Ne tani s'duhet të na ndajë më njeri...

Ajo qëndroi pa e kuptuar as vetë se ç'forcë e brendshme e ndali.

Po Share Gremi nuk bëri më tutje.

— Po punokan! — tha, e, duke u ngjitur majë asaj mezhde i kundroi së andejmi që të gjithë. Pastaj edhe ata të dy.

— Sa hije që kanë! — tha dhe ashtu, i emocionuar, pa i ndarë nga sytë, ua bëri me dorë.

— Telo, — mërmëroi ajo e lumtur. — Shikoje! Babai...

— I gëzuar Teloja ngriti dorën dhe përshëndeti xha Sharen.

Pastaj dhe ajo.